




asi

ASSEMBLY SUPPORT INITIATIVE
NEWSLETTER

Qershor 2005, Nr 17



**“Parlamentarët nuk janë nga Marsi
por nga Kosova”**

Debat me kryesuesit e grupeve parlamentare




Mirëseerdhët ambasador Verner Vnent

Sekretari i Përgjithshëm i KB-ve Kofi Anani ka emëruar ambasadorin Verner Vnent si zëvendës-PSSP, përgjegjës të shtyllës së III-të të UNMIK-ut për ndërtim të institucioneve, që drejtohet nga OSBE-ja. Ambasadori Vnent, ka lindur në vitin 1952, dhe është diplomat i karrierës, i cili punën në Shërbimin për Marrëdhënie me Jashtë të Gjermanisë e ka filluar me 1980. Para se të emërohej në postin e Shefit të Misionit të OSBE-së në Kosovë me 28 prill 2005, ambasadori Vnent kryente detyrën e Zëvendës Përfaqësuesit të Lartë në Zyrën e Përfaqësuesit të Lartë në Bosnje Hercegovinë, post në të cilin ishte emëruar në vitin 2003.

Kuvendi i Kosovës dhe Pakti i Stabilitetit për Evropën Jug-Lindore: Një fillim i ri

Doina Ghimici, OSBE



STABILITY PACT
FOR SOUTH EASTERN EUROPE

Në Tryezën e Rrumbullakët të Paktit të Stabilitetit, që u mbajt në Portorozh të Sllovenisë, në qershor të vitit 2004, u rikonfirmua se bashkëpunimi parlamentarë është objektivi kryesor i këtij Pakti. Së këndejmi, përmes iniciativës së Paktit të Stabilitetit, deputetët e parlamenteve nëpër tërë rajonin e Evropës Jug-Lindore inkurajohen që ta avansojnë bashkëpunimin e ndërsjellë, gjatë përbaljes me sfida të ndryshme si rritja e efikasitetit të punës parlamentare dhe fuqizimi i rolit të parlamenteve në proceset e politikëbërjes dhe mbikëqyrjes. Pos kësaj, në kuadër të paktit të Stabilitetit promovohen edhe shkëmbimet midis parlamenteve të rajonit dhe atyre të UE-së gjatë procesit të integritimeve Euro-Atlantike. Pakti i Stabilitetit luan një rol të jashtëzakonisht të dobishëm në përcaktimin e prioritetëve, duke bërë të mundur takimet midis përfituesve dhe donatorët, shmangien e dyfishimit të aktivitetëve dhe rritjen maksimale të efikasitetit të programeve të ndryshme të donatorëve, dhe një koordinimin më efikas të donatorëve ndërkombëtarë.

Grupi Punues (Task Force) për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Paktit të Stabilitetit takohet dy herë në vit, përafërsisht një muaj para mbledhjes së Tryezës së I-rë të Punës të Paktit të Stabilitetit, brenda të cilit funksionon. Në këto takime shqyrtohen çështjet e ngritura nga parlamentarët e Evropës Jug-Lindore dhe programi i punës së Grupit Punues (Task Force), të cilat gjithnjë marrin parasysh iniciativat, që janë ndërmarrë tanimë nga institucionet dhe qeveritë e tjera, e që kanë për qëllim jo vetëm identifikimin e mangësive, por edhe impenjimin për tejkalimin e tyre. Veç takimeve me donatorët dhe agjencitë implementuese, parlamentarët nga rajoni ftohen që të marrin pjesë edhe në mbledhjet e Grupit Punues për ta fuqizuar

rolin e tyre në përafrimin e rajonit me Paktin e Stabilitetit.

Mbledhja e fundit e Grupit Punues për Bashkëpunim Parlamentar u mbajt me 15 prill 2005 në Bruksel. Ishte hera e parë që Kuvendi i Kosovës u përfaqësua në një ngjarje të këtillë. Me ftesën e Goran Svilanoviçit, kryesuesit të Tryezës së I-rë, në këtë ngjarje morri pjesë edhe deputeti i Kuvendit të Kosovës z. Enver Hoxhaj, i cili i informoi të pranishmit lidhur me zhvillimet aktuale në Kosovë, duke u ndalur me këtë rast te sfidat kryesore me të cilat po ballafaqohen si legjislativi ashtu edhe shoqëria e Kosovës, në përgjithësi. Ai vuri në dukje, që në fillim se mentaliteti para së gjithash i deputetëve të Kosovës duhet të ndryshohet sa më parë. Njëherit, Enver Hoxhaj theksoi rëndësinë që ka për Kuvendin e Kosovës, si një institucion i ri parlamentar, intesifiki i kontakteve dhe mësimi nga përvojat e legjislativave të tjera në rajon. Vlen të vihet në dukje se prezenca e deputetit të Kuvendit të Kosovës në mbledhjen e Paktit të Stabilitetit dhe kontributi i tij në këtë u mirëprit nga të pranishmit. Ndaj, pritet që përfshirja e Kuvendit të Kosovës në rrjetin e bashkëpunimit të Paktit të Stabilitetit të bëhet e përhershme.

Po në këtë ngjarje, Misioni i OSBE-së bëri të ditur nismën e tij për të organizuar, në bashkëpunim me Kuvendin e Kosovës, një tryezë të rrumbullakët parlamentare, e cila do t'ua bënte të mundur deputetëve nga Evropa Jug-Lindore që ta vizitojnë Prishtinën dhe të njihin më për së afërmi me realitetin e Kosovës. Njëherit, me këtë rast deputetët e Kosovës do të kishin mundësi që t'i shkëmbejnë përvojat dhe praktikat më të mira mbi çështjet me interes të përbashkët me kolegët e tyre nga rajoni. Si kryesuesi i Tryezës së I-rë të Punës ashtu edhe koordinatori i Grupit Punues e mirëpritën iniciativën dhe ranë dakord që ta përfshijnë këtë ngjarje në kuadrin e Paktit të Stabilitetit. Data e parashikuar për mbajtjen e tryezës së rrumbullakët është 10 qershori, e cila koïncidon me gjashtë vjetorin e Paktit të Stabilitetit.

“Na nevojiten më tepër dinamizëm në Kuvend”

Në edicionin aktual të buletinit ASI, përqendrohemi më tepër në rolin dhe mendimet e grupeve parlamentare në Kuvendin e Kosovës. Ne e kemi intervistuar znj. Gjylnaze Syla, Shefe të grupit parlamentar të AAK-së.

Intervistoi: Edita Buçaj, OSCE

Cili është qëllimi kryesor dhe qasja e grupit parlamentar të AAK-së në mandatin aktual të Kuvendit?

Duke qenë partnerë në qeverinë e koalicionit, ne e kemi qëllim përbushjen e aspiratave tona dhe mbrojtjen e interesit të qytetarëve të Kosovës përmes programit të qeverisë. Ne duhet t'i japim përkrahje të plotë prioriteteve të qeverisë dhe strategjisë së definuar të saj, implementimit të agjendës së vet, si dhe promovimit të politikave qeveritare.

Ne e zbatojmë një politikë inkluzive dhe jo përjashtuese. Ne dëshirojmë që ta kultivojmë kulturën politike dhe të bëjmë çmos që të mos vie deri të marrëdhëniet e acaruar me opozitën. Ne e inkurajojmë bashkëpunimin konstruktiv dhe tolerancën. Ne avokojmë për pjesëmarrjen në proceset e Kosovës dhe në jetën institucionale në përgjithësi.

Çka është arritur në punën e Kuvendit dhe çka mund të përmirësohet?

Kapacitetet e Kuvendit për të siguruar hapësirën e nevojshme dhe kushtet e punës për anëtarët janë ngritur. Administrata e Kuvendit është më mirë e trajnuar dhe është fuqizuar puna e komisioneve të Kuvendit. Komisionet janë më aktive dhe ato më shpesh mbajnë dëgjime publike, gjë që e shton transparencën.

Puna në Kuvend mund të jetë më dinamike, seancat plenare më të shpeshta dhe roli i komisioneve të forcohet përmes personelit kompetent shtesë. Anëtarët e Kuvendit duhet



të bëhen ekspertë në fusha të caktuara dhe t'i shfrytëzojnë me efikasitet mekanizmat për monitorimin e punës së Kuvendit.

Megjithatë, në Kosovë si edhe në vendet e tjera, ne ballafaqohemi me resurse të kufizuara. Për këtë arsye, bashkëpunimi me shoqërinë civile duhet të zgjerohet me qëllim të përfitimit nga informatat që ata i posedojnë si edhe nga rekomandimet e tyre.

A ka debat të mjaftueshëm në Kuvend?

Kuvendi është vend për debate, por edhe për pajtimet, eliminimin e mosmarrëveshjeve, ndërtimin e kompromiseve ose koncenzusit. Siç kam thënë, puna e Kuvendit duhet të intensifikohet, çka do të thotë më tepër takime, më tepër mundësi për debate, dhe si rezultat do të kemi bashkëpunim më të shpeshtë dhe më të afërt ndërmjet anëtarëve të parlamentit. Kjo është thelbësore për kohën

kur duhet të merren shumë vendime të rëndësishme për të ardhmen e Kosovës. Ne mendojmë se për zhvillimin e demokracisë së qëndrueshme në Kosovë na nevojiten më tepër seanca në muaj se sa është rasti tani. Planifikimi paraprak i orarit të seancave, së paku gjashtë në muaj, gjithashtu do ta shtonte efikasitetin e punës së Kuvendit.

Si e vlerësoni nivelin e implementimit të legjislacionit?

Arsyet për mosimplementimin ose implementimin e pjesërishtë të ligjeve janë të shumëllojshme. Kur kemi parasysh nevojën urgjente për shumë ligje, Qeveria ka qenë nën presion të kohës për t'i hartuar ato dhe Kuvendi për t'i miratuar ato. Një mangësi ka qenë edhe fakti se nuk ishte paraparë sa do të kushtojë projektligji. Si pasojë, ka munguar monitorimi i efikasitetit të ligjit. Një nga arsyet për këtë është mungesa e konsultimeve me autoritetet komunale gjatë

procesit të draftimit të ligjeve. Po ta kishim bërë këtë, ne do t'i shmangeshim shumë vështirësive gjatë implementimit të ligjeve nga komunat. E dyta, ka mungesë të kontakteve të rregullta me votuesit tanë. Grupi parlamentar i AAK-së do të bëjë vizita në terren për të parë se si po zbatohet programi i qeverisë. Kjo do të na mundësojë neve që të gjejmë problemet për implementimin e ligjeve, të mundohemi të përgjigjemi dhe të reagojmë.

Cili është qëndrimi juaj për takimin e mundshëm të Presidentit dhe Kryeministrit të Kosovës me udhëheqësit e Serbisë?

Kosova dëshiron marrëdhënie paqësore me të gjithë fqinjët, përfshirë këtu edhe Serbinë. Takimet midis udhëheqësve të lartë të Kosovës dhe Serbisë mund të zhvillohen në nivel të bashkëpunimit të mirë fqinjësor dhe konstruktiv. Të gjitha çështjet që janë në interes të përbashkët të të dyja palëve mund të diskutohen, siç janë çështja e personave të kidnapuar dhe të pagjetur, pensionet e vjedhura, dëmet e shkaktuara gjatë luftës, dokumentacioni kadastral etj. Ose implikimet që vijnë nga pavarësia e Kosovës, por jo për statusin final të Kosovës.

Cili është qëndrimi juaj sa i përket dosjes së dorëzuar nga PDK-ja për një pjesë të anëtarëve të qeverisë?

Bindja ime është se kjo është çështje e gjyqësisë. Vendimet duhet të merren nga gjykatat. Të gjithë duhet të jemi të përgjegjshëm për veprimet tona dhe për pasojat e veprimeve tona.

“Parlamentarët nuk janë nga Marsi por nga Kosova”

Nuk ndodhë edhe aq shpesh që Shefat e grupeve parlamentare të ulen – zyrtarisht – për të diskutuar së bashku rreth punës së Kuvendit dhe zhvillimeve politike aktuale. Me 9 maj 2005, Prof. Alush Gashi nga LDK-ja, Z. Jakup Krasniqi nga PDK-ja, Zonja Teuta Sahatqija nga ORA dhe Z. Mahir Jagxhillar nga 6+ u takuan për të diskutuar në debatin e organizuar nga Misioni i OSBE-së dhe gazeta ditore kosovare Express. Në vijim po japim transkriptin e këtij diskutimi mjaft të gjallë.

Intervistën e zhvilluan Edita Bucaj dhe Arlinda Desku.

Sa jeni të kënaqur më mënyrën e funksionimit të Kuvendit të Kosovës dhe a ka diçka që nuk ecë?

Jakup Krasniqi: Mund të themi se Kuvendi ka funksionuar vetëm në një segment: në miratimin e ligjeve. Edhe pse kjo është çështje shumë e rëndësishme, megjithatë nuk është e vetmja. Kuvendi duhet të merret edhe me krijimin e grupeve të ndryshme të kontrollit. Duhet ta kontrollojë Qeverinë. Duhet ta ketë një kontroll më të fuqishëm mbi Buxhetin e Kosovës. Kuvendi duhet të jetë vend ku bëhet politikëbërja. Kuvendi, në fakt, nuk është duke e kryer një detyrë shumë të rëndësishme që ka – kujdesin për sigurinë e vendit dhe të qytetarëve. Edhe pse segmenti i sigurisë dhe i drejtësisë është i rezervuar, kjo

nuk do ta pengonte Kuvendin të merrej me këto çështje. S’di a arrinë Kuvendi t’i kryejë 15 përqind të punëve që do duhej t’i kryente.

A e ka edhe LDK të njëjtin mendim? A është shndërruar Kuvendi vetëm në një makinë për miratimin e ligjeve?

Alush Gashi: Gjatë kësaj faze të ndërtimit të institucioneve demokratike në Kosovë, është shumë e evidente që kemi një progres. Por, natyrisht, edhe fakti se ende qehemi institucione të përkohshme - tregon për nevojën e zhvillimit të këtij procesi. Mendoj se në shoqërinë tonë nevojitet debati.

I cili nuk ekziston në Kuvend...

Alush Gashi: Për çështjet të cilat hyjnë në rend të ditës, mendoj se

në Kuvend debatohet më një kulturë të lakmueshme. Deputetët i qasen debatit shumë seriozisht. Ekziston një kulturë e komunikimit në seancat plenare. Kemi shumë çështje për të cilat tash, fatmirësisht, kemi përgatitje institucionale që t’i debatojmë. Shpresoj se në Kuvend do të ketë më shumë seanca dhe më shumë debat.

Opozita kritikon Kuvendin për mungesë debati, madje Kryeparlamentarin Nexhat Daci e quan uzurpator të fjalës së lirë. Ndërkohë Alush Gashi thotë se ka një kulturë komunikim të mirë në Kuvend. Zonja Sataqija, si thoni ju?

Teuta Sahatqija: Secila parti, secili deputet, duhet ta ketë vendin e vet, hapësirën kohore në të cilën do ta paraqiste mendimin e vet. Meqë unë i përkas një grupi që në këtë legjislacion është opozitë, mendoj se ne do duhej ta kishim këtë hapësirë. Është çështje tjetër nëse ai mendim pranohet ose jo. Por, së paku, duhet të ekzistojë hapësira për të folë.

A e ka ORA atë hapësirë?

Teuta Satahqiya: Nuk e kemi hapësirën e mjaftueshme. Të shumtën e kohës ne flasim për atë se pse nuk mund të flasim, sesa për vetë çështjen për të cilën dëshirojmë të flasim.

A ka debat në Kuvend dhe sa ka PDK hapësirë që të flasë?

Jakup Krasniqi: Nuk nuk ka parlament në botë që ka më pak debat. Në Kuvendin e Kosovës nuk ka debat. Unë i kam thënë grupit tim parlamentar, pasi drejtoj një grup prej 30 deputetësh, që mos të gjuajnë

fjalë derisa dikush flet, sepse është foltorja dhe mendimet le të shprehen hapur dhe jo në mikrofon të mbyllur. Në vendet tjera opozita është më e pakulturoar në veprimet e pozitës. Te ne ndodh e kundërta. Pozita është e padurueshme ndaj mendimit të kundërt. Ka reagime nga më të ndryshmet, gjuajtje fjalësh, shqelmime. Pra, nuk ka gatishmëri për ta dëgjuar mendimin e kundërt. Prandaj, Daci, duke e parë këtë padurueshmëri të shumicës, në një mënyrë e ngulfatë debatin.

Opozita ka qëndrime të ndryshme me juve zoti Gashi, sa i përket kësaj çështje....

Alush Gashi: Ne aktualisht jemi duke punuar me disa rregullore. Janë duke u bërë përpjekje që Kuvendi i Kosovës ta ketë një rregullore më të mirë dhe mendoj se kjo rregullore ka gjasa t’i eliminojë dobësitë, nëse ekzistojnë. Por, sigurisht, do të ofrojë më shumë hapësirë për debat.

PDK dhe ORA dhanë një përgjigje të drejtëpërdrejtë dhe thanë se Kryeparlamentari Daci po e mbyl debatin. A ka mundësi që edhe ju ta jepni një përgjigje të drejtëpërdrejtë. A është kjo e vërtetë?

Alush Gashi: Mendoj se çështja e menaxhimit të seancave kërkon mjaft bisedë e debat. Angazhimi i grupit tonë parlamentar është që në Kuvend të respektohen proceduar, mbi bazën e të cilave funksionon. Por, aktualisht punojmë më tepër se me një rregullore. Shpresoj se me miratimin e rregullorës së re, do të ketë mundësi që deputetët të



kenë më shumë se këta minuta që i kanë tani.

Z. Yagcilar, a mendoni se zhvillohet debat i mirë në Kuvend?

Mahir Yagcilar: Nga aspekti i grupit parlamentar "6+", ne kemi qenë gjithmonë të kujdesshëm/të matur me kryetarin Daci sa i përket debatit, kështu që gjithmonë kemi pasur mundësinë që të shprehim mendimet tona.

Kryeparlamentari Daci ka kërkuar që seancat parlamentare të mos monitorohen më nga OSBE. Ishte kjo një kërkesë e drejtë?

Teuta Sahatqija: Nuk mendoj se është kërkesë e drejtë. Nëse i shqyrtojmë raportet që sjell OSBE, shohim se aty vërehen parregullësi. Pastaj, duke marrë parasysh se jemi ende të rinj në këtë punë, është shumë i mirë-seardhur një monitorim që do të na tregonte një rrugë.

Jakup Krasniqi: Mendoj se Daci nuk është dashur ta kërkonte heqjen e monitorimit, por është

dashur që me punën e tij gjatë kësaj periudhe ta bindë OSBE, opozitën dhe të tjerët, që të punon në mënyrë demokratike dhe vërtet OSBE mos të ketë nevojë të monitorojë.

Alush Gashi: Mua me vjen mirë që puna e Kuvendit është transparente. Unë nuk jam në dijeni se grupi ynë parlamentar ka kërkuar që OSBE të mos i monitorojë seancat...

Po, Nexhat Daci e ka kërkuar një gjë të tillë nga Soren Jessen-Petersen.

Alush Gashi: Ndoshta ne formë të një deklarate, por për më tepër - nuk di. Nëse Kryetari Daci ka folë lidhur më atë se është bërë përparim dhe nuk ka nevojë për monitorim, përparimet janë evidente. Personalisht më vjen mirë që seancat plenare janë transparente. Angazhimi im është që edhe në punët e komisioneve të ketë sa ma shumë vëzhgues. Andaj, edhe ka qenë iniciativë e LDK, të cilën OSBE e ka pranuar, që të kemi studentë të vitit të III dhe IV që do ta ndihmojnë

punën e komisioneve.

Funksionimi i institucioneve demokratike është një prej standardeve që duhet plotësuar. Sa e ka plotësuar këtë standard Kuvendi?

Jakup Krasniqi: Është shumë vështirë të themi se Kuvendi ka plotësuar në përmasat e merituar këtë standard. Që nga fillimi i këtij mandati, është marrë kryesisht vetëm me ligjet, duke ngulatur në të gjitha format tjera debatin. Kjo është për të të ardhur keq.

Teuta Sahatqija: Do duhej edhe shumë më tepër të investohej në demokratizim, që Kuvendi të jetë demokratik. Mendoj që për çfarëdo çështje që ka të bëjnë me shqetësimet e shoqërisë, do duhej të kishte debat të menjëherëshëm, e jo të kemi bllokim të nismave në Kryesi të Kuvendit. Mendoj se këtu kemi një ndeshje të madhe. Kishim rastin me decentralizimin, i cili ka kohë që u kërkuar të debatohet, por nuk nodhi kështu.

Pse është shtyrë debatimi i decentralizimit deri me sot?

Alush Gashi: Ne që nga dita e parë kemi mbështetur kërkesen për debat në seancë plenare.

Por, nuk ka ndodhur.

Alush Gashi: Shpresoj që kjo do të ndodhë. Siç e dini, është çështja e ndërrimit të Qeverisë. Megjithatë, me më shumë përpjekje, ndoshta ka mundur të zhvillohet javën e kaluar.

Pse Kuvendi mbledhet vetëm një herë në muaj? Për këtë çështje, së fundi, është ankuar edhe vetë Jessen-Petersen. Çfatë po bëni kështu?

Alush Gashi: Besoj se ngritja e kapaciteteve në Kuvend dhe në Qeveri për përgatitje të seancave tash është më e mirë.

Pra, ju jeni të kënaqur?

Alush Gashi: Ngritja e kapaciteteve në institucionet e Kosovës është më e mirë tani sesa që ishte në legjislacionin e kaluar. Tash të gjitha parakushtet janë



që Kuvendi i Kosovës të ketë seanca më shpesh, dhe në ato seanca të ketë debat për nevojat e qytetarëve të Kosovës. Unë besoj se kjo do të ndodhë.

Por ja që nuk po ndodh momentalisht...

Alush Gashi: Përgatitja, kapaciteti i hartimeve të ligjeve në Qeverinë e Kosovës, është ky që ekziston. Kapaciteti i përpunimit të dokumenteve në Kuvend të Kosovës është më i mirë se në të kaluarën. Prandaj, ne tash jemi në fazën kur do të mund të debatojmë çështje të cilat janë të rëndësishme përveç miratimit të ligjeve.

Zoti Krasniqi, më herët thate se nuk ka një kulturë të mirë komunikimi në Kuvend, por edhe juve ju kanë kritikuar se po keqpërdorni foltoren.

Jakup Krasniqi: Do të kisha dëshiroja të më thuhet: "e ke thënë këtë fjalë... dhe me këto fjalë e ke prishë".

Ju kanë kritikuar për akuzat që keni bërë në Kuvend, duke thënë se një pjesë e kabinetit qeveritar është e inkriminuar, ndërkohë që kjo ende nuk është vërtetuar...

Jakup Krasniqi: Unë nuk kam bërë akuzë. Unë kam ngritur shqetësimet e mia dhe të qytetarëve. Kam kërkuar nga Kuvendi që ta formojë një komision hetimor – për ato shqetësime që kam shprehur.

Pse nuk votoi LDK për formimin e këtij komisioni hetimor, zoti Gashi?

Alush Gashi: Para se të formohet komision hetimor, jemi të interesuar që së paku Kryesia e Kuvendit ta ketë një material, në bazë të të cilit do të vlerësojë nëse vlen të formohet një komision i tillë ose jo. Nuk e konsiderojmë refuzimin, por përfillje të një procedure.

Nëse ju dorëzohet ai dokument

me akuzë, do të votoni për formimin e komisionit hetimor?

Alush Gashi: Nëse na dorëzohet dokumenti, atëherë do ta shqyrtojmë atë dokument, e pastaj do të dalim me një qëndrim publik në seancë plenare.

Pse PDK nuk po e dorëzon dokumentin në Kuvend?

Jakup Krasniqi: Gjërat nuk do të shtrohen kështu. Ne e kemi dorëzuar një dokument aty ku duhet. Ai nuk është për Kuvend. Por, Kuvendi do duhej të merrej me këtë çështje, edhe pa atë dokument, sepse parlamentarët nuk janë të Marsit por janë të Kosovës. Dhe, në Kosovë është folë e shkruar për këtë çështje, edhe në televizione edhe në gazeta. Këto do duhej të ishin të mjaftueshme që të formohen komisione hetimore, të kontrollohet pasurimi i njerëzve të pushtetit, të vërtetohet nëse ato pasuri janë të ligjtshme ose jo. Ka akuzë nga më të ndryshmet. Nëse formohet komisioni hetimor, deputetët me siguri se do t'i marrin edhe materialet. Unë kam kërkuar që komisioni hetimor pos që mund ta ketë atë material, duhet edhe të bashkëpunojë me policinë hetimore dhe me gjyqësinë.

A kanë partitë politike shërbime sekrete?

Jakup Krasniqi: Nuk është puna e ime të vërtetoj nëse partitë politike kanë shërbime sekrete. Sigurisht se partitë kanë shërbime të ndryshme që ju duhen. Qëllimi nuk është ku janë marrë ato dokumente, por a janë të qëndrueshme ato që ngriten në ato dokumente.

A është SHIK-u shërbim i fshehtë i PDK-së?

Jakup Krasniqi: Jo. Nuk jemi as organ as njerëz që do të merremi me shërbime sekrete në Kosovë. Në Kosovë veprojnë shumë shërbime sekrete, ndoshta edhe jashtë partive politike. Ne jemi grup parlamentar që kërkojmë

që siguria e qytetarëve dhe funksionimi i sistemit të drejtësisë të jenë në nivel.

Z. Gashi, a është Sigurimi i Atdheut shërbim i fshehtë i LDK-së?

Alush Gashi: Urdhëroni?

A ka LDK shërbim të fshehtë i cili quhet Sigurimi i Atdheut?

Gashi: Unë jam kryetar i grupit parlamentar të LDK. Ne nuk jemi në dijeni për një shërbim të tillë. Unë nuk jam në dijeni për një shërbim të tillë as si anëtar i Kryesisë së LDK.

Po ORA....?

Teuta Sahatqija: Jo, ska. Mendojmë që policia jonë, institucionet tona, duhet të jenë më syhapur dhe t'i zbardhin këto. Vetë fakti i moszgjidhjes së këtyre rasteve, mund të krijojë mundësinë e formimit dhe ekzistimit të tyre.

Ka një presion të bashkësisë ndërkombëtare për një takim Rugova-Tadic. Si mendoni ju, a duhet të ndodhë ky takim?



Alush Gashi: Se si do të vendosë Presidenti Rugova, do të jetë vendim legjitim i tij. Por, jam i bindur se çështjet nuk mund të zgjidhen mes Prishtinës dhe Beogradit.

Çfarë qëndrimi ka LDK për këtë çështje?

Alush Gashi: Këtë çështje, në një mbledhje formale, nuk e kemi diskutuar. Rugova është Presidenti i qytetarëve të Kosovës dhe mendoj se kjo nuk është çështje vetëm e vendimit të partisë sonë, por besoj se Presidenti do ta ketë në konsideratë këtë, para marrjes së vendimit. LDK e ka qëndrimin e qartë sa i përket raporteve me Serbinë. Mendojmë se nevojitet zyrtarizimi i pavarësisë së Kosovës, se kjo çështje nuk mund të zgjidhet mes Serbisë dhe Kosovës.

Jakup Krasniqi: Vendimin për të biseduar me Serbinë duhet të merret në Kuvendin e Kosovës. Mendoj se pa u diskutuar kjo çështje në Kuvend, nuk do duhej të ndodhte ai takim. Por, debati nuk është ngulatur vetëm në Kuvend, por edhe në kuadër të

Anëtarët e Kuvendit të Kosovës i drejtohen seminarit regional të Asamblesë parlamentare të NATO-s

“Drejt integritet euro-atlantik: progresi dhe sfidat në Evropën jug-lindore”

Për shkak të dinamikës aktuale në Kosovë, Kuvendit i nevojitet përkrahje shtesë për themelimin e rrjetit të kontakteve dhe marrëdhënieve regjionale si dhe për zhvillimin e mekanizmave të bashkëpunimit ndërkombëtar. Lidhur me këtë të tretën, Misioni i OSBE-së ka bërë të mundur pjesëmarrjen e anëtarëve të Kuvendit të Kosovës në zhvillimet e Asamblesë Parlamentare të NATO-s. Anëtarët e Kuvendit Gjylnaze Syla dhe Oliver Ivanoviq ishin të pranishëm në seminarin e 59-të Rose-Rose të organizuar në bashkëpunim me Parlamentin e Kroacisë në Dubrovnik nga 12-14 mars 2005. Ishin të pranishëm më se 60 anëtarë të parlamenteve nga shumica e shteteve dhe partnerëve të NATO-s, përfshirë këtu edhe presidentin e Asamblesë Parlamentare të NATO-s z. Pierre Lellouche. Znj. Syla dhe Z. Ivanoviq kontribuan si panelistë në diskutimin për Kosovën.

Doina Ghimici, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Perspektiva e integritet në Unionin Evropian është një nxitje e fuqishme, kanë konkluduar pjesëmarrësit, dhe ofruan një kornizë të përgjithshme për stabilizimin dhe tranzicionin e shteteve që kanë dalur nga ish-Jugosllavia. Situata e përgjithshme në Evropën jug-lindore është përmirësuar në mënyrë substanciale në krahasim me dhjetë vitet e fundit, mirëpo njëkohësisht, janë shumë probleme që kanë mbetur. Këto probleme dhe procese që kanë gjasë të zhvillohen në periudhën vijuese – posaçërisht për Kosovë dhe Serbi dhe Malin e Zi – kërkojnë përkushtim afatmesëm dhe afatgjatë të bashkësisë ndërkombëtare në regjion, dhe në veçanti të UE-së dhe NATO-s. Bashkësia ndërkombëtare dhe vet regjioni do të ballafaqohen me sfida të mëdha: të merren me zhvillimet e ardhshme ashtu që stabiliteti i arritur me mund të madh në regjion të mos dëmtohet.

Përkundër shumëllojshmërisë së interesave dhe mendimeve, shumica e pjesëmarrësve të seminarit janë pajtuar që çështja e pazgjidhur e statusit të Kosovës është si problem i madh për bashkësinë ndërkombëtare ashtu edhe faktor që e ndërlikon situatën në Kosovë dhe Serbi dhe Mal të Zi. Doli se debati, madje edhe në Serbi, tanimë ka ndryshuar nga a duhet të diskutojmë për statusin final, në një çfarë formati të fillohen negociatat e ardhshme për statusin.

Parlamentarët e NATO-s dhe bashkëbiseduesit e tyre regjional janë pajtuar se Beogradi dhe Prishtina duhet të përfshihen në kornizën negociuese, si edhe serbët e Kosovës, mirëpo nëse negociatat do të tregohen të suksesshme, nevojiten përpjekje të ripërtirra për stimulimin e dialogut ndëretnik, dhe rindërtimin e besimit ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë, si dhe përmirësimin e kanaleve të komunikimit midis Beogradit dhe Prishtinës. Përveç kësaj, Evropa duhet ta theksojë qartë perspektivën e UE-së edhe për Serbinë edhe për Kosovën, d.m.th. t'i tregojë dy shtigje të ndara por paralele për UE.

Në diskutimin e panelit për të ardhmen e Kosovës, Joaquin Molina, i cili është përgjegjës për Kosovën përbrenda Divizionit të NATO-s për menaxhimin e krizave, prezantoi qendrimin e bashkësisë ndërkombëtare nga perspektiva e sigurisë. Duke folur për paraqitjen e një qasjeje më gjithëpërfshirëse për sigurinë në Kosovë, posaçërisht në aspekt të vlerësimit gjysëmvetor të Standardeve, Z. Molina spikati bashkëpunimin e përmirësuar UNMIK-IPVQ dhe UNMIK-KFOR, dhe operacionet më të mira të KFOR-it. Ai gjithashtu theksoi domosdoshmërinë për të adresuar perceptimin mbi sigurinë. Duke rikujtuar se profili i NATO-s në Kosovë është rritur, zyrtari i

NATO-s konfirmoi angazhimin afatgjatë të Aleancës në Evropën juglindore dhe Kosovë. Ndonëse NATO nuk është organizatë përgjegjëse për përkufizimin e statusit të ardhshëm të Kosovës, NATO do të luajë rolin politik në kornizën e zgjeruar të Kontakt Grupit në diskutimin politik “për përfitimin e njerëzve dhe për koordinimin më të mirë ndërmjet bashkësisë ndërkombëtare dhe IPVQ-ve”. Z. Molina ka kërkuar nga parlamentarët e NATO-s të përkrahin çfarëdo iniciativash konstruktive për Kosovën; nga serbët e Kosovës të marrin pjesë në institucione, përfshirë këtu edhe Komisionin e lartë këshillëdhënës për sigurinë, duke e bërë të qartë se kontaktet joformale nuk janë zëvendësim për pjesëmarrje; dhe nga IPVQ-të dhe njerëzit në Kosovë të punojnë në përmirësimin e ndjenjës së sigurisë dhe lëvizshmërisë për minoritetet, dhe të luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Duke folur për herë të parë para asamblesë ndërparlamentare, Gjylnaze Syla, shefe e grupit parlamentar të AAK-së, e bëri një prezantim të mirëpritur të titulluar “Rruga para nesh”. Duke e theksuar paqartësinë lidhur me të ardhmen e Kosovës, Znj. Syla foli së pari në emër të të gjithë njerëzve të Kosovës, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike, të cilët kërkojnë prosperitet ekonomik, arsim dhe siguri. Duke e

vërejtur se rruga deri te këto qëllime kalon nëpër demokracinë e konsoliduar dhe sundimin e ligjit, marrëdhëniet më të mira regjionale, integritetin evropian dhe anëtarësinë në organizatat si NATO, anëtarja e Kuvendit ka theksuar pamundësinë e arritjes së këtyre qëllimeve në mungesë të vendimit për statusin përfundimtar të Kosovës. Znj. Syla ka treguar se IPVQ-të po bëjnë përpjekje t’i përbushin Standardet sikur ato “të ishin të domosdoshme për t’u bërë shtet”, dhe e ka dhënë një refleksim të përpjekjeve të IPVQ-ve, përfshirë këtu edhe arritjen deri te komunitetet minoritare dhe përballimin me dinjitet të aktakuzës së Ramush Haradinajt. Ajo gjithashtu i ka përmendur disa bllokime të rrugëve dhe ndikimin negativ që e ka paqartësia e statusit posaçërisht në ekonominë e Kosovës, dhe foli në lidhje me kontributin për stabilitetin regjional dhe zhvillimet që do t’i shkaktonte një Kosovë e pavarur.

Pas znj. Syla, Oliver Ivanoviq, tanimë i njohur me Asamblesë Parlamentare të NATO-s për shkak të kontributeve të tij në të kaluarën para parlamentarëve të NATO-s, e bëri një prezantim të titulluar “E tashmja e mbetur në të kaluarën”. Përderisa kolegja e tij shqiptare nga Kosova i ka përmendur përpjekjet e suksesshme, z. Ivanoviq i ka vënë në spikamë kryesisht të metat, duke

Zhvillimet e fundit në institucionet e Kosovës



Qeveria e re e zgjedhur më 23 mars 2005

Pas dorëheqjes së z. Ramush Haradinaj nga posti i kryeministrit më 8 mars 2005, Kuvendi i Kosovës e ka zgjedhur qeverinë e re më 23 mars 2005. Kuvendi e ka zgjedhur nënkryetarin e AAK-së Bajram Kosumin për kryeministër së bashku me kabinetin e propozuar, që kishte vetëm disa ndryshime të vogla në krahasim me kabinetin e mëparshëm. Para se të votonte Kuvendi, u zhvillua një debat i gjerë. Anëtarët e koalicionit folën për përkrahjen e tyre për qeverinë e re si vazhdimësi e qeverisë së suksesshme të udhëhequr nga z. Haradinaj, përderisa ata nga opozita e kritikuan qeverinë për prezentimin e një programi të paqartë. Kuvendi e ka votuar qeverinë me 71 vota për dhe 36 vota kundër.

Ministrat vizitojnë të zhvendosurit kosovarë në Mal të Zi

Një delegacion i përbashkët i përbërë nga UNMIK-u dhe IPVQ-të e vizitoi Malin e Zi prej 8-10 prill 2005 me qëllim që të shqyrtohet pozita e të zhvendosurve kosovarë të vendosur në qendrat kolektive atje. Ministri për kthim dhe komunitete Slavisha Petkoviq, Ministri i pushtetit lokal Lutfi Haziri, dhe zëvendës drejtori i Zyres për kthim dhe komunitete biseduan me të zhvendosurit në qendrat kolektive të Beranes dhe Konikut, në Podgoricë, si dhe me përfaqësuesit e Ministrisë së punës dhe mirëqenies shoqërore dhe Komisionerin për të zhvendosurit të Malit të Zi. Është arritur pajtimi që të vazhdohen bisedimet për bashkëpunim në të ardhmen sa i përket kthimit në Kosovë.

Në Prishtinë u mbajt takimi i Grupit të Kontaktit

Në Prishtinë më 12-13 prill 2005, u mbajt takimi i Grupit të Kontaktit (GK). Drejtorët politik nga vendet e GK mbajtën takimin me zyrtarët e UNMIK-ut dhe liderët politik dhe institucional të Kosovës. Kjo ishte hera e parë që GK ishte mbledhur në nivel të tillë në Kosovë. GK deklaroi se ata ishin të inkurajuar nga progresi i bërë për disa standarde dhe ka dalluar një "ndjenjë të re të gatishmërisë" për t'u përfshirë në dialogun midis serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës. Ata theksuan se rezultatet e decentralizimit në Kosovë janë mënyra

më e mirë për ta forcuar multietnicitetin dhe kanë këshilluar që të dyja palët duhet të jenë të gatshme për të bërë kompromise në bisedat për statusin. Në këtë kontekst, dialogu është çelës për ta krijuar "kornizën e besimit" para bisedave për statusin. Kryeministri Kosumi theksoi gatishmërinë e qeverisë për t'u përfshirë për momentin vetëm në dialogun teknik me Beogradin dhe insistoi se pavarësia është opcioni i vetëm në bisedat për statusin. Liderët e opozitës ishin shumë kritik ndaj procesit të decentralizimit si të tillë çfarë njihet tani dhe me atë që ata e shohin si "mosfunksionim" të institucioneve demokratike në Kosovë. Liderët e listës serbe për Kosovë dhe Metohi (SLKM) e shpallën qëllimin e tyre që të ripërfshihen në grupet punuese për decentralizimin dhe t'i rikthehen Kuvendit dhe Qeverisë. Ata e kanë shprehur përkrahjen e tyre për më tepër pilot projekte të decentralizimit.

Seanca e tendosur e Kuvendit më 21-22 prill 2005

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës e mbajtur më 21-22 prill u përcoll me largimin në formë proteste të dy grupeve kryesore opozitare, PDK-së dhe ORA-ës, pasi që propozimet e tyre për rendin e ditës ishin refuzuar. PDK-ja propozoi që, përveç pikave që tashmë ishin paraparë në rendin e ditës, Kuvendi duhej ta përfshinte diskutimin për decentralizimin, formimin e ad-hoc komisionit i cili do t'i hetonte aktet e supozuara kriminale të anëtarëve të

kaktuar të qeverisë, dhe ORA mocionin ku përmendeshin shkeljet procedurale në seancën e mëparshme plenare. PDK-ja gjithashtu propozoi shtyrjen e miratimit të Ligjit për komisionin e pavarur të mediave (KPM) dhe Rregulloren e re të punës së Kuvendit, duke thënë se asnjë prej tyre nuk duhet të miratohet në formën aktuale.

Kuvendi e ka kaluar pas leximit të dytë projektligjin për shërbimet sociale dhe familjare dhe projektligjin për Komisionin e pavarur të mediave. Kuvendi gjithashtu e ka kaluar në leximin e parë projektligjin për trajnimin dhe arsimin e të rriturve, projektligjin për themelimin e institutit juridik të Kosovës, projektligjin për tokën bujqësore dhe projektligjin për procedurat administrative. Anëtarët e Kuvendit e kanë shtyrë për seancën e ardhshme të Kuvendit leximin e dytë të projektligjit për banim. Kuvendi gjithashtu i ka shqyrtuar dhe miratuar vërejtjet e Komisioneve të Kuvendit dhe UNMIK-ut për Ligjin për tregëtinë e naftës dhe derivateve të naftës, të miratuar më 17 prill 2004, dhe për Ligjin kundër korrupsionit, të miratuar më 8 shtator 2004.

PSSP-ja shpreh brengosjen e tij për seancën e Kuvendit të mbajtur në prill

Më 29 prill, PSSP-ja i ka dërguar letër Kryesisë së Kuvendit duke e shprehur brengosjen e tij me ngjarjet që ndodhën në seancën plenare të 21-22 prillit, pasi që ka pranuar raportin e monitorimit të Kuvendit nga OSBE-ja për seancën në fjalë. Në letër, PSSP-ja ka kërkuar nga Kryesia e Kuvendit, dhe në veçanti nga Kryetari i Kuvendit Nexhat Daci, të bëjë përpjekje më të mëdha për t'i marrë parasysh interesat e të gjitha entiteteve politike të përfaqësuara në Kuvend. Ai ka shkruar se veprimet e fundit siç janë mohimi i të drejtës për të folur gjatë debatit, vendimet unilaterale për t'i fshirë deklaratat e anëtarëve të Kuvendit nga procesverbali, dhe kërcënimet për largimin e anëtarëve të Kuvendit nga seancat e ardhshme plenare mund ta dëmtojnë kredibilitetin institucional të Kuvendit. Letra iu referua propozimeve të OSBE-së për përforcimin e mekanizmave të brendshëm korrigjues të Kuvendit, duke mbajtur takime të rregullta me Kryesinë e Kuvendit dhe duke punuar me komisionin legjislativ, që ka rol në zgjidhjen e mospajtimeve procedurale.

Diskutimi për krijimin e "Forumit të Kosovës"

Më 29 prill, PSSP-ja ishte nikoqir i një dreke për liderët politik kryesorë të shqiptarëve të Kosovës. Diskutimi u përqendrua në përmirësimin e marrëdhënieve midis qeverisë dhe opozitës dhe në formimin e një forumi politik përfshirës që do t'i merrej me çështjet kryesore siç janë standardet, dialogu me Beogradin, decentralizimi dhe bisedat për statusin ku do përfaqësoheshin të gjithë faktorët kryesorë politik në Kosovë. Sipas PSSP-së, "kjo nuk do të jetë zëvendësim i institucioneve por përkrahje për institucionet ekzistuese dhe dialog për çështjet kyçe". PSSP-ja më pas dërgoi propozimin me shkrim për forumin për t'u aprovuar nga liderët. Reagimet fillestare për këtë ide e shpalosin dallimin në përcëptim midis LDK-së dhe PDK-së për rolin e një forumi të tillë, ku LDK-ja e përkrah rolin këshillëdhënës dhe PDK-ja rolin vendimmarrës për forumin. PSSP-ja është takuar me Grupin e Kontaktit (GK) Plus në Prishtinë për të diskutuar qëllimet e nismës së "Forumit të Kosovës"; është shprehur përkrahje e plotë për këtë nismë nga ana e përfaqësuesve të GK Plus.

Ministrat arrijnë deri te Kisha ortodokse serbe

Më 25 prill, PSSP-ja ka nxjerrë një urdhër ekzekutiv duke e shpallur si zonë speciale kanjonin e Deçanit, ku gjendet manastiri ortodoks serb Visoki, i shpallur nga UNESCO-ja si vend i trashëgimisë botërore. Sipas urdhërit ekzekutiv, që do të jetë në fuqi për gjashtë muaj me mundësi të vazhdimtë të tij, nuk do të lejohet kurrfarë aktiviteti industrial ose komercial në kanjon pa e pasur autorizimin e miratuar nga UNMIK-u. Pronarët dhe shfrytëzuesit e tokës në këtë zonë duhet t'i përmbahen ligjeve të Kosovës dhe standardeve të UNESCO-s për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Më 1 maj, PSSP-ja së bashku me Ministrin e mjedisit dhe planifikimit hapësinor Ardian Gjinin dhe Kryetarin e kuvendit komunal, iu kanë përgjigjur ftesës së Peshkopit Teodosije dhe kanë qenë të pranishëm në drekën e pashkëve ortodokse në Manastirin Visoki. Ishte hera e parë që nga konflikti që zyrtarët shqiptarë të Kosovës morrën pjesë në një festë të tillë religjioze të rëndësishme në këtë manastir.

Më 10 maj, Ministri i kulturës, rinisë dhe sportit, Astrit Haraqija, ka njoftuar për themelimin e Komisionit implementues për rindërtimin e objekteve fetare. Misioni i komisionit bazohet në Memorandumin e mirëkuptimit në parimet e përgjithshme për rindërtimin e kishave ortodokse dhe objekteve të tjera fetare të dëmtuara gjatë trazirave të marsit, të nënshkruar nga Patriarku Pavle në emër të Kishës ortodokse serbe dhe Ministrin Haraqija. Komisioni do t'i implementojë rekomandimet e përmbledhura në raportin e vlerësimit teknik të Këshillit të Evropës dhe UNESCO-s për rindërtimin e 35 kishave dhe objekteve të tjera.

Kuvendi debaton reformimin e pushtetit lokal

Më 19 maj 2005 në seancën plenare të Kuvendit u mbajt debati i pritur gjatë mbi decentralizimin dhe procesin e reformimit të pushtetit lokal. Kryeministri -Bajram Kosumi dhe Ministri për Pushtetin Lokal - Lutfi Haziri- paqaritën deklaratat e tyre hyrëse. Ata theksuan konceptin prapa procesit të tanishëm për reformimin e pushtetit lokal, objektivat kryesore dhe zhvillimin e tyre që nga fillimi i procesit i inicuar nga Kryeministri Regjepi. Ministri gjithashtu ka elaboruar mbi përmbajtjen dhe kornizën kohore të propozimit të qeverisë, kuptimin e pilot komunave dhe rëndësinë e projektit për qeverisje të mirë në Kosovë. Kryesuesitë e gjithë grupeve parlamentare morrën fjalën dhe komentuan aspekte të ndryshme si p.sh qëndrueshmërinë financiare të pilot komunave të reja, kompetencat e administratës lokale, rolin e Kuvendit në procesin e ardhshëm vendimmarrës etj. Më shumë se 100 (nga gjithsej 120) deputetë morrën pjesë gjatë seancës. Anëtarët serbë të LSKM munguan duke vauhdur kështu bojkotimin e tyre të IPVQ.





Do të doja që në emër të Qeverisë t'i prezantojë të arriturat dhe sfidat me të cilat jemi duke u përballuar në procesin politik. Siç e dini, Qeveria e Kosovës ka pranuar vlerësimin e fundit teknik i cili thekson zhvillime pozitive dhe rezultate të prekshme në zbatimin e Standardeve.

Standardet nuk i shohim si diçka të imponuar nga bashkësia ndërkombëtare. Ato duhet të reflektojnë shkallën e zhvillimit të shoqërisë sonë. Sa më shumë t'i përmbushim standardet aq më e lartë do të jetë shkalla e demokracisë në Kosovë. Ne jemi shumë optimist se ky proces është në rrugë të drejtë dhe se mekanizmat për të vazhduar janë krijuar. Gjatë muajve të fundit janë organizuar debate me qytetarë në pothuajse te gjitha komunat e Kosovës. Këto debate kanë për qëllim ngritjen e vetëdijes tek qytetarët për rendësin e standardeve si dhe janë mënyra më e mirë për komunikim direkt me qytetarët.

Pjesëmarrja e minoriteteve në institucionet demokratike të Kosovës është çështje kyçe për të cilën po punon Qeveria. Vendimi i disa politikanëve serbë, pas zgjedhjeve të nëntorit 2004, për të marrë pjesë në institu-

cionet demokratike të Kosovës pavarësisht nga sugjerimet e Beogradit është shenja më pozitive në politikën e serbëve në Kosovë. Ndaj, Qeveria e ka mirëpritur këtë vendim.

Njëherit, Qeveria ka ndërmarrë dhe ka implementuar hapa konkretë për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve, veçanërisht të komunitetet serb, në institucione të Kosovës. Kështu, ata tani mbajnë poste të larta në sektorin e shërbimit civil dhe në të njetën kohë Qeveria ka miratuar edhe strategjinë që ka për qëllim rritjen e përqindjes së punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve, e cila aktualisht është 10.2%; 2600 minoritarë, shumica e të cilëve janë serb, janë të punësuar në administratën qendrore të qeverisë dhe të institucioneve qeveritare. Kohë më parë është marrë edhe vendimi për emërimin e një këshilltari politik (nga rradhët e komuniteteve pakicë) në Ministrinë e Arsimit, i cili do të jetë përgjegjës për çështje të politikave arsimore të minoriteteve.

Në fushën e marrëdhënieve ndër-etnike, angazhim i veçantë po vazhdon në integrimin e bashkësive etnike si dhe në procesin e përmirësimit të lirisë së lëvizjes

“Serbët do të kenë një të ardhme të sigurt në Kosovë”

Pjesë nga fjalimi i kryeministrit Bajram Kosumi mbajtur me rastin e vizitës së ambasadorëve të NATO-s në Prishtinë me 13 maj 2004

dhe kthimit të refugjatëve. Ministri i Pushtetit Lokal z.Haziri së bashku me Ministrin për Kthim dhe Komunitete z. Petkoviç kanë përfunduar vizitat e refugjatëve në Mal të Zi dhe Maqedoni. Kryetarët e komunave janë duke arritur rezultate të mirëfillëta në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike, posaçërisht në sferën e kthimit, të drejtave pronësore, lirinë e lëvizjes dhe përdorimin e gjuhëve. Kështu, në Teatrin Kombëtar në Prishtinë, më 3 maj të këtij viti, një trupë teatrore e Beogradit ka bërë një shfaqje në orët e vona të mbrëmjes dhe teatri ka qenë i mbushur përplot me shikues, gati se të gjithë serbë. Ky është një shembull i thjeshtë, por tregon se lëvizja e lirë e njerëzve është duke u normalizuar.

Në pjesën më të madhe të Kosovës nuk ka probleme në lëvizjen e lirë të njerëzve. Ky problem është më i theksuar vetëm në pjesën veriore të Kosovës. Ndaj, duhet të përballlemi dhe ta zgjidhim këtë çështje sa më parë.

Qeveria ka proceduar Ligjin për gjuhët zyrtare në Kosovë. Minoritetet përdorin lirisht gjuhën e tyre në administratën publike, ndërsa shqipja dhe serbishtja janë gjuhë zyrtare në tërë Kosovën. Minoritetet shkollohen në gjuhën e tyre dhe kanë tekstet mësimore në gjuhën e tyre. Ata përdorin lirisht simbolet kombëtare dhe i kremtojnë festat e tyre tradicionale dhe fetare.

Janë themeluar dy zyre (një në nivel qendror – në Ministrinë e Shërbimeve Publike dhe një

në nivel lokal – në Ministrinë e Pushtetit Lokal) për monitorimin e dy-gjuhësisë. Tanimë janë siguruar fondet për pajisjet për përkthim simultan në të gjitha komunat e Kosovës, bashkëpunim ndërmjet Qeverisë së Britanisë së Madhe dhe Qeverisë së Kosovës.

Decentralizimi paraqet vetëm një segment të reformës së mirëfilltë të pushtetit lokal. Ju e dini se ne kemi aprovuar projektin e pilot komunave dhe këtu para jush dëshiroj të ri-konfirmoj se Decentralizimi do të ndodhë edhe përkundër disa mospajtimeve me partitë opozitare. Unë personalisht jam angazhuar në bisedime direkte me partitë dhe liderët opozitarë për çështjen e decentralizimit. Tanimë kemi caktuar 19 majin si datë për debat në Kuvend. Unë jam i përkushtuar që rekomandimet e partive opozitare të gjejnë vend në projektin e pilot komunave. Në fillim të korrikut, Qeveria do të jetë në gjendje t'i tregoj rezultatet e para konkrete në zbatimin e pilot projekteve ku përfshihen 5 njësi komunale.

Këto pilot-projekte janë edhe një ofertë e Qeverisë për komunitetin serb: ju e dini se në disa pilot-komuna shumica e banorëve janë serbë. Me procesin e decentralizimit, ata do të kenë shumicën në kuvendet komunale, do ta kenë kryetarin serb dhe do të mund të marrin vendime për problemet e përditshme me të cilat ballafaqohen komunitetet e tyre. Njëherit, me këtë proces, ne duam të dërgojmë mesazhin tonë se serbët kanë të ardhme të sigurt në Kosovë.

“Standardet janë diskredituar për shkak të ndërlidhjes së tyre me diskutimin mbi statusin”

Standardet prioritare, të përqëndruara në të drejtat e minoriteteve, janë bërë qendra e vet procesit politik. Ne kemi intervistuar z. Oliver Ivanoviq, kryesuesin e LSKM, për të mësuar qëndrimet e tij.

Intervisën e zhvilloi Vasilija Staniq.

Në ç'masë mendoni se janë plotësuar standardet prioritare?

Idea e standardeve është diskredituar. Standardet e jetës nënkuptojnë diçka që do të zgjat dhe që do të orientojë drejt vlerave europiane. Dhe për rrjedhojë standardet duhet të ofrojnë kushte më të mira për jetë qytetarëve. Porse plotësimi i standardeve nuk është test që ne duhet ta kalojmë tani dhe të përfundojë çdo gjë pasi të marrim një notë. Është dëshpruese, mirëpo standardet janë diskredituar në momentin kur është vendosur që plotësimi i standardeve të ndërlidhet me bisedimet mbi statusin. Tani kemi situatën ku implementimi i standardeve humb vlerën meqë fokusimi në status diskrediton standardet. Kjo në një masë diskrediton edhe bashkësinë ndërkombtare, sepse askush nuk beson në ndonjë qëndrim të ngjajshëm që mund ta shprehin në të ardhmen.

Ju besoni se nuk do është me rëndësi nëse standardet janë implementuar apo jo?

Jam plotësisht i sigurtë se bisedimet do të fillojnë në tetor. Jam plotësisht i sigurtë që standardet prioritare nuk do të jenë as për së afërmi të plotësuar as deri në qershor dhe as deri atëherë, kur është planifikuar vlerësimi i plotësimit të standardeve. Duke u bazuar në atë vlerësim ata dëshirojnë të marrin vendimin

për fillimin e bisedimeve. Nëse vetëm e analizojmë standardin e parë – funksionimin e institucioneve demokratike – është më se e qartë që ai standard nuk është plotësuar. E zgjedha me qëllim këtë standard sepse shpesh lidhet me pjesëmarrjen tonë në institucione. Sido që të jetë dikush mund të keqpërdor pjesëmarrjen tonë në institucione duke thënë “ja tani ata janë këtu, dhe institucionet janë multietnike” dhe automatikisht të shtojnë edhe fjalën “dhe demokratike”, gjë që nuk do të ishte mirë.

A po flisni për ndonjë involvimi të mundshëm në Kuvend apo edhe në Qeveri?

Ne do të shqyrtojmë edhe pjesëmarrjen në qeveri, por jo me çdo kusht. Ne do të insistojmë të marrim atë që na takon. Sipas Kornizës Kushtetuese ne përfaqësojmë komunitetin serb dhe kemi të drejtën për të zënë të gjitha ato pozita të rezervuara për serbët. Ne duhet të ulemi dhe të bisedojmë me përfaqësuesit e koalicionit qeverisës LDK dhe AAK. Z. Petersen duhet gjithashtu të marrë pjesë në bisedime, dhe ne duhet të arrijmë ndonjë marrëveshje. Për mua ekzistojnë tri zgjedhje të mundshme: pjesëmarrja në të gjitha institucionet, hyrja në Kuvend ku punojmë si opozitë e mirëfilltë apo nuk marrim pjesë fare. Çdo gjë varet nga rezultatet e bisedimeve.



Sa i përket standardeve, a shihni lëmi ka janë arritur zhvillime pozitive? P.sh përperjekjet e komunave për të implementuar politikat gjuhësore apo zhvillime të caktuara në trupat Mbrotjtëse të Kosovës (TMK)?

Jam i sigurtë që këto standarde do të shfrytëzohen për të ilustruar faktin që ka pasur zhvillime pozitive. Ata përdorin statistika për të treguar p.sh se TMK është multietnike dhe se ka një numër të caktuar të pjesëtarëve të minoritetit. TMK duhet të jetë një organizatë që ofron ndihmë në raste të fatkeqësive natyrore. Fakti që kjo organizatë shumë shpesh, madje për çdo ditë shpreh dëshirën për tu bërë armatë, paraqet jo vetëm shkelje të standardeve por edhe shkelje të Kornizës Kushtetuese. Çështja e përdorimit të barabartë të gjuhëve do të thotë që të gjitha gjuhët: serbe, shqpe, dhe mundësisht ajo angleze të përdoren çdokund në çdo insitucion apo organizatë. Dhe kjo nuk do të thotë që vlenë vetëm për shenjat e trafikut. Emrat e qyteteve dhe fshatrave po ndërrohen. Për këtë deklaroj që standardet nuk janë plotësuar. Kohëve të fundit po kemi shenja për Obilić në gjuhën serbe po me alfabetin latin, ndërkohë që

do të duhej të ishte në alfabetin çirilik sespe ai është alfabeti ynë zyrtar. Obiliqi kurrë nuk ka qenë Kastriot. Kamenica e Kosovës është Kamenica e Kosovës dhe jo vetëm Kamenicë, njësoj si Mitrovica e Kosovës. Rregullorja e UNMIK-ut duhet ti parandalojë këto gjëra, por si duket nuk i obligon as kompanitë dhe as komunat që vendosin këto shenja. Idea është që të shkelputet çdo lidhje me të kaluarën sepse si e tillë është e keqe.

Pak më parë ju ishit në The-sali si anëtarë i delegacionit të Kuvendit të Kosovës. Meqë edhe bashkëpunimi rajonal është pjesë e standardeve, cilat janë përshtypjet tuaja?

Të gjitha vizitat rajonale kanë një gjë të përbashkët: të shkëmbejnë përvojat në punën parlamentare, me fjalë të tjera, pasurimi i njohurive tona. Të gjitha parlamentet merrin me të drejtat e njeriut. Kjo është shumë me rëndësi për ne, sepse çfarëdo që të jetë vendimi ynë lidhur me pjesëmarrjen tonë në Qeveri, ne gjithmonë do të kritikojmë punën e atyre që nuk respektojnë Kornizën Kushtetuese, Rregullat dhe rregulloret dhe politikat e dizanuara. Këtë herë ne do të gjejmë një aleat natyror nga opozita shqiptare për të kritikuar punën e Qeverisë.

Jam tejet i angazhuar në procesin e standardeve

Nga Xhoshua Bllek, Zyra amerikane në Prishtinë



Si diplomat i ShBA-ve në Kosovë, fjalën "Standardet" e kam zënë në gojë aq shumë sa që vërtetë nuk më kujtohet dot se sa herë e kam shqiptuar. Këtë fjalë e kam përsëritur vazhdimisht në mbledhje, në televizion dhe në biseda të panumërta me liderët kosovarë. Por, ndonëse jam mërzitur së shqiptuari këtë fjalë- dhe pavarësisht nga ajo se sa lodhen kosovarët së dëgjuari këtë fjalë – unë megjithatë kujtoj që standardet janë shpresa e vetme e Kosovës për t'u bërë në një shoqëri e mirëfilltë dhe me perspektivë.

Këtë gjë e kam kuptuar gjatë këtyre shtatë muajve sa jam duke punuar në Zyrën Amerikane në Prishtinë. Ndaj, duke shërbyer në detyrën e përkohshme të caktuar nga Stejt Departmani në Uashington, unë pata rastin që të njihem me esencën e standardeve: mbledhjet që mbahen aktualisht, raportet, politikat, dhe startegjitë që institucionet e Kosovës janë duke i aplikuar lidhur me standardet. Kjo përvojë kam mësuar shumë se pse standardet janë aq të rëndësishme dhe pse Shtetet e Bashkuara duhet t'i ndihmojnë Kosovës për t'i përmbyshur ato. Puna rreth standardeve është përqëndruar në Grupet Punuese, të cilat tani janë duke u takuar të paktën çdo tri javë. Ndaj, tok me kolegët e komunitetit diplomatik ndërkombëtar, unë kam kaluar orë të tëra në Ministrinë

e Shërbimeve Publike, në sallën e konferencave në katin e dytë, duke i vëzhguar dhe duke marrë pjesë në këto mbledhje.

Do t'a them troç: nganjëherë këto mbledhje ishin të mërzitshme, veçanërisht në fillim, kur dukej se zyrtarët qeveritarë nuk po i kuptonin standardet. Së këtejmi, raportet për standardet shpeshherë ishin të mangëta apo edhe pretendohesh se nuk ishin të mbështetura në fakte. Pos kësaj, mungonte edhe komunikimi midis UNMIK-ut dhe qeverisë apo edhe përbrenda vetë ministrive në qeveri. Madje shumë shpesh, më ka rënë të takoj edhe zyrtarë, të cilët nuk ishin në gjendje t'i kryenin punët dhe detyrat si duhet, përkundër përpjekjeve dhe dëshirës së tyre, ngase u mungonin si njohuritë dhe shkathësitë ashtu edhe mjetet.

Mirëpo, me kalimin e kohës Grupet Punuese filluan të shënojnë përparime. Kësisoj, raportimi u përmirësua dhe tani mbështetjet më tepër në fakte. Prezantimet u bënë më konkrete dhe më të përqëndruara. Zyrtarët e qeverisë kishin mësuar se si t'i kuptonin drejtë dhe t'i shndërronin frazat e rëndësishme si "liria e lëvizjes" ose "sundimi i ligjit" në përmirësime reale dhe konkrete në terren. Gjerë më tani Grupi i Punës ka ndërmarrë dhe miratuar një mori masash, politikash, programesh të reja, dhe ç'është më e rëndësishmja, qëndrimesh të reja. Ndonëse, ka mbetur ende punë për t'u bërë, këto grupe – dhe shprehitë e punës që i kanë krijuar—japin shpresë dhe flasin mirë për të ardhmen e Kosovës.

Pos rezultateve të arritura, unë kam kam vërejtur edhe një ndryshim të tonit për standardet. Për një kohë të gjatë, kosovarët i kanë konsideruar standardet si një barrë që u është ngarkuar

nga jashtë dhe të cilat nuk kanë kurrfarë rëndësie për jetën e tyre të përditshme. Mirëpo, duket se, gjatë muajve të fundit, shumica e zyrtarëve të qeverisë në grupet punuese por edhe ata jashtë tyre, e kanë sfiduar këtë pikëpamje.

Ndaj dhe liderët kosovarë tani gjithnjë e më tepër po i përshkruajnë standardet si diçka të rëndësishme dhe të vlefshme për vetë shoqërinë e Kosovës. Madje, një zyrtar më pohoi se, "standardet nuk janë as për UNMIK-un, dhe as për bashkësinë ndërkombëtare--standardet janë për Kosovën." Dukej sheshit se ai e kishte të qartë se ky proces ka të bëjë me shndërrimin e Kosovës në një vend më tolerant dhe më të dëshirueshëm për të jetuar për të gjithë qytetarët--qoftë të shumicës apo të pakicës--. Së këndejmi, ma thotë mendja se ky ndryshim në konceptim është më i rëndësishëm sesa verifikimi i më tepër se njëqind kutive në dokumentin e Planit për Implementimin e Standardeve për Kosovën KSIP (PISK).

Me të dëgjuar për ndryshimin e tonit dhe qëndrimit, unë vura re se në të vërtetë këto vlera—idetë e tolerancës dhe lirisë që përbëjnë thelbin e standardeve – kanë qenë në themelet e politikës së ShBA-ve, shumë para se fjala "standardet" të shqiptohesh dhe dëgjohej ndonjëherë. Kështu, nevoja për këto standarde lindi nga tmerret që i përjetoi Kosova gjatë viteve të 90ta, kur dhuna etnike nxiti intervenimin e bashkësisë ndërkombëtare. Atëbotë, liderët si Bill Kllintoni dhe Madllin Ollbrajt dhe kolegët e tyre ndërkombëtarë, besonin se Kosova mund të ndysohej. Ata ishin të mendimit se në Kosovë mund të ndërtohej një shoqëri ku asnjë qytetarë nuk do të druante nga dhuna apo nga mohimi i të drejtave të tij/ saj për shkak të përkatësisë etnike. Ky vizion, më vonë i përfshirë

edhe në standarde, janë arsye të përse kemi ardhur në Kosovë. Kjo vazhdon të mbetet politika jonë edhe sot.

Prandaj, standardet do të jenë të rëndësishme për Kosovën edhe shumë kohë pas vlerësimit të hollësishëm të plotësimit të tyre aty nga mes i vitit 2005 dhe pas përcaktimit të statusit final. Në fakt, kësaj pune kurrë nuk do t'i vie fundi. Të gjitha shoqëritë demokratike duhet vazhdimisht të punojnë për të ndërtuar institucione të mirëfillëta, të cilat do t'a luftojnë korrupsionin, zhvillojnë ekonominë, dhe t'i mbrojnë të drejtat e minoriteteve. Së këndejmi, liderët në çdo vend të botës, përfshirë këtu edhe vendin tim, e kanë detyrë të përhershme që të sigurojnë që të gjithë qytetarët, në veçanti ata që janë më të ndjeshëm dhe më të cënueshëm, të kenë qasje të barabartë në demokraci dhe siguri.

Nga ana ime, shpresoj se ia kam dalur mbanë t'i ndihmoj ndopak popullit të Kosovës në avansimin drejt këtyre qëllimeve. Njëherit, shpresoj se kam arritur që edhe të jap kontributin tim modest për forcimin e mëtejme të marrëdhënieve tanimë tejet miqësore midis ShBA-ve dhe popullit të Kosovës. Por, kujtoj që ne mund t'a thellojmë edhe më tej miqësinë tonë, duke i ardhur në ndihmë Kosovës në rrugën e saj drejt përmbyshjes së standardeve, të cilat do ta bëjnë Kosovën një vend më të mirë dhe më të përshtatshëm për të jetuar për të gjithë qytetarët e saj.

Xhoshua Bllek është marrë me çështjen e Kosovës në Stejt Departman të ShBA-ve për pesë vite. Tani punon si zyrtarë për Kosovën në Stejt Departman të ShBA-ve në Uashington. Bllek ka shërbyer edhe në Zyrën e ShBA-ve në Prishtinë (USOP), gjatë periudhës 2001-2002 dhe 2004-2005.

Implementimi i Standardeve për Kosovën - dinamizimi afatshkurtë që shpie drejt rezultateve afatgjata

Johan Te Velde, Misioni i OSBE-së në Kosovë, Drejtor i Departamentit të Demokratizimit



“Kriteret”, “Standardet”, “Standardet për Kosovën”, “Plani për Implementimin e Standardeve për Kosovën”, “Standardet Prioritare” – implementimi i standardeve ka kaluar nëpër faza të ndryshme. Ajo që fillimisht ishte njëfarë plani i përgjithshëm për vendosjen e parimeve demokratike dhe të komunitetit evropian në Kosovë më vonë u shndërruan në kriteret dhe plan për Kosovën, ku qaratat vihen në spikamë si qëllimet ashtu edhe partnerët implementues. Për më tepër, me formën që kanë marrë tani ato janë bërë edhe si mjete për analizimin dhe implementimin e politikave të IPVQ-ve (Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes) dhe për vlerësimin e punës së tyre.

“Standardet” janë politika e UNMIK-ut për Kosovën. Ndaj, bisedimet për Kosovën do të fillojnë, vetëm nëse Kosova do të shënojë përparime të dukshme në plotësimin e kushteve të përcaktuara në Planin për Implementimin e Standardeve për Kosovën. Standardet merren me aspekte kualitative të shoqërisë kosovare, gjë e cila varet nga implikimet praktike të vendimeve politike, e të cilët janë kruciale për situatën në Kosovë. Standardet, në mes të tjerash, kërkojnë dhe impenjohen për krijimin e institucioneve publike

representative dhe demokratike, për sundimin dhe respektimin e ligjit në mënyrë efektive, për liri të lëvizjes së qytetarëve të Kosovës pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike, për një ekonomi funksionale të tregut dhe për Trupa të Mbrojtjes së Kosovës, që do të operojnë brenda mandatit të tyre.

Pas marsit të vitit 2004 ishte më se e qartë se aspekti i standardeve që ka të bëjë me komunitetet ishte më i rëndësishëm se kurrë. S’do mend se standardet prioritare janë vendosur për arsye se bisedat për statusin final të Kosovës do të mund të zhvilloheshin vetëm nëse do të bëhej e mundur që grupet etnike të Kosovës të jetonin së bashku në paqe.

Departamenti i Demokratizimit në kuadër të Misionit të OSBE-së në Kosovë është duke dhënë kontributin e tij për përmbushjen e standardeve, dhe njëherit është duke i përkrahur IPVQ-të për arritjen e këtyre standardeve. Kështu, departamenti është duke punuar me institucionet e nivelit qendror, në kuadër të Iniciativës për Mbështetje Kuvendit, për të përkrahur funksionimin e Kuvendit. Veç kësaj, është duke ndihmuar edhe Zyrën e Kryeministrit dhe Institutin Kosovar për Administratë Publike. Ndërkaq, në procesin e reformimit të pushtetit lokal, departamenti është duke përkrahur Ministrinë e Pushtit Lokal, Administratën dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës. Po kështu, ekzistojnë edhe një mori iniciativash nga shoqëria civile, që kanë për qëllim krijimin e masave të mirëbesimit dhe promovimin e kulturës demokratike. Për më tepër, mbështetja për zhvillimin e mediave, si fjala

vjen në hartimin e ligjeve dhe në ndërtimin e kapaciteteve të tyre për transmetim, siç është rasti me RTK-në apo edhe mediat e shtypura, është po ashtu një nga qëllimet kryesore të Departamentit të Demokratizimit. Të gjitha këto aktivitete si në nivelin qendror ashtu edhe në nivelin lokal janë duke u zbatuar përmes tetë zyreve të OSBE-së në terren. Departamenti është angazhuar jo vetëm në monitorimin (përcjelljen e proceseve të vendimmarrjes së IPVQ-ve dhe implementimin e tyre), por edhe në dhënies së ndihmës IPVQ-ve për vënien në jetë të standardeve.

Politika ‘Standardet para statusit’ ka shënuar një dinamizim gjatë kohës sa ishte kryeministër z. Haradinaj, dhe kjo gjë është duke vazhduar edhe tani kur kryeministër është z. Bajram Kosumi. Përvojat e vendeve të tjera na mësojnë se një plan nacional i hartuar në mënyrë koherente dhe të qartë, i cili gëzon mbështetjen e popullit është mjet i fuqishëm për realizimin e reformave. Ndaj dhe veprimet e IPVQ-ve tani kanë qëllime dhe orientime më të qarta.

Meqë, tanimë IPVQ-ët i kanë të qarta prioritetet e tyre, ato dinë çfarë ndihme të kërkojnë nga OSBE-ja, ndaj nuk presin që OSBE-ja të dalë me oferta për asistencë teknike. Kështu që, tani janë IPVQ-ët ato që kërkojnë ndihmë për ndërtimin e kapaciteteve. Ne i mirëpresim këto zhvillime, ngase ndërtimi i kapaciteteve kërkon që agjenda të përcaktohet nga partnerët që i marrin shërbimet tona. Së këndejmi, janë IPVQ-ët ato që duhet t’a marrin iniciativën, ngase kësaj IPVQ-ët sigurojnë

jo vetëm kompetencën mbi këto çështje por edhe qëndrueshmërinë e tyre. Njëherit, në këtë mënyrë ato sigurojnë që asistencën e ofruar të jetë vërtetë e nevojshme. S’do mend se OSBE-ja i ka politikat dhe programet e saja dhe nuk mund t’i plotësojë të gjitha kërkesat e IPVQ-ve, të cilat duhet të përshtaten dhe përputhen me politikat dhe programet e OSBE-së.

Pas vlerësimit të progresit të bërë në implementimin e standardeve në mesin e këtij viti, ekziston droja se ndryshimet që kanë filluar tani, nuk do të mund të përfundojnë deri kur të vijë koha për vlerësimin e tyre. S’ka pikë dyshimi se ky ritëm është arritur edhe në sate të perspektivës, mjaft joshëse për shqiptarët e Kosovës, për diskutimin e statusit të Kosovës. Disa kosovarë standardet i kanë kuptuar si provim, i cili duhet të kalohet. Fjala vjen, njëra nga kërkesat është që në rrugë të vendosen shenjat në të dy gjuhët. Ndërsa, në njërin nga komunat një shërbyes civil lidhur me këtë pat thënë se “shenjat në rrugë duhet të shënohen edhe në gjuhën angleze, ngase atyre (bashkësisë ndërkombëtare) do t’i vinte mirë” (sic!), duke lënë të kuptohet se politika e standardeve është hartuar për t’i kënaqur ndërkombëtarët.

Nëse merret vendimi që të fillohen bisedimet për statusin e ardhshëm, atëherë do të ndysojnë edhe prioritetet e IPVQ-ve. Kështu që, qeveria do t’a përqëndrojë vëmendjen krejtësisht tek bisedimet rreth statusit të ardhshëm; kjo mbase është e paevitueshme. Mirëpo, qysh tani mund të ndërmerren masa parandaluese për t’u siguruar që ‘loja e fajësimit’, që

është përmendur në një artikull të edicionit të muajit shkurt të FOCUS-it nga z. Dickinson nuk do të fillojë sërish. Është e udhës të theksohet se "Politika e standardeve" mbase do të mund të pasohet menjëherë nga politika e hyrjes në UE, mekanizmi përcjellës i stabilizim-asocimit. Njëherit, roli i mediave dhe shoqërisë civile është që ta mbajnë kursin e IPVQ-ve drejt sëndërtimit të këtyre synimeve. Kështu që, OJQ-ët mund të dalin me propozime për një politikë aletrnativë pas shqyrtimit të statusit, ndërsa mediat mund t'i monitorojnë veprimet e IPVQ-ve në mënyrë kritike dhe konstruktive.

Në kuadër të politikave të ardhshme do të duhej të përfshiheshin ndihmat e bashkësisë ndërkombëtare IPVQ-ve, në mënyrë që të vihen në jetë reformat, të cilat tanimë kanë filluar. Kësaj, ca ligje të Kuvendit të Kosovës do të duhej të përmirësoheshin dhe plotësoheshin, ngase ato janë miratuar nxitimthi për shkak të procesit të përbushjes së standardeve. Me këtë rast, duhet siguruar që të gjitha ligjet të mbështeten me një strategji dhe politikë të qartë dhe koherente. Ligjet janë udhëzime teknike në funksion të një politike, ndaj kjo politikë duhet kuptohet dhe të përvetësohet si duhet nga IPVQ-ët, të cilat i zbatojnë këto ligje. Kështu, nëse një institucion i caktuar i IPVQ-ve përgatitë një plan veprues, atëherë OSBE-ja, nëse kërkohet, mund të japë ndihmën e saj për ndërtimin e kapaciteteve.

Në fund vlen të vihet në dukje se ritmet e tanishme duhet të përshpejtohen. Pra, IPVQ-ët nuk duhet t'a ngadalësojnë ritmin e tyre pas vlerësimit të standardeve. Ndaj, mediat, shoqëria civile dhe Kuvendi kanë një detyrë mjaft të rëndësishme, për të mbështetur dhe monitoruar qeverinë e tyre, në mënyrë që të sigurojnë se vendimet e marra do të sjellin reforma të mirëfillta dhe afatgjata.



Institut International
du Paris La Sorbonne

Një mbështetje e rëndësishme e tri parlamenteve

Projekti shumëdimensional i IMKK-së (ASI-it) "Iniciativës për Mbështetje Kuvendit të Kosovës", i cili zgjati tetëmbëdhjetë muaj, dhe kishte për qëllim ngritjen e kapaciteteve të Kuvendit të Kosovës, përfshirë këtu rritjen e efikasitetit të punës së deputetëve, në seanca plenare dhe në komisione, dhe përsosjen e veprimtarisë së stafit profesional të Kuvendit, përfundoi me sukses.

Prof. Dr. Fatmir Sejdiu



Ky projekti i financuar nga AERI është vënë në jetë nga ekspertë të profileve të larta të Bundestagut Gjerman, Asamblesë Franceze dhe Dhomës Përfaqësuese të Parlamentit Belg. Në këtë projekt, pos tjerash, janë zhvilluar edhe aktivitete rreth bashkëpunimit dhe përfshirjes së Kuvendit të Kosovës në punën e parlamenteve evropiane, që kishin për qëllim intensifikimin e veprimtarisë legjislative dhe harmonizimin e saj me standardet evropiane. Përveç hulumtimit të gjendjes së përgjithshme në Kuvendin e Kosovës, projekti është përqëndruar edhe rreth vlerësimit të nevojës për përkrahimin e stafit të Kuvendit përmes trajnimeve në fusha të ndryshme si, legjislacion, buxhet dhe teknologjisë informative.

Dukej se në fillim projekti nuk dha edhe aq shumë rezultate.

Mirëpo, në fazat e mëvonshme filluan të vërehen rezultate konkrete në të gjitha fushaveprimtaritë. Vlen të vihet në pikamë se këto trajnimeve, që janë mbajtur në pjesë të ndryshme të Kosovës, kanë bërë të mundur jo vetëm ngritjen e cilësisë së punës, por edhe rritjen e efikasitetit të punës së ekipeve parlamentare. Krahas kësaj, projekti është marrë edhe me përgatitjen e një varg projektesh që kanë të bëjnë qoftë me Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës dhe rregulloret për sistematizimin e veprimtarisë së brendshme të Kuvendit qoftë edhe me çështje të tjera nga fusha të ngjashme, të cilat si tërësi paraqesin korpusin e brendshëm rregullativ të Kuvendit të Kosovës.

Në kuadër të kësaj mbështetjeje që iu dha Kuvendit të Kosovës nga ana e këtyre tri parlamenteve vend të veçantë zë krijimi i lidhjeve të drejtpërdrejta dhe forcimi i bashkëpunimit midis drejtuesve të udhëheqësve parlamentarë të kuvendeve dhe deputetëve të Kuvendit të Kosovës si me deputetët ashtu edhe me vet parlamentet e këtyre tri vendeve.

Organizimi i tryezave të rrumbullakëta ka bërë të mundur shkëmbimin e drejtpërdrejtë të ideve dhe përvojave lidhur me avansimin e proceseve demokratike dhe sqarimin e

roleve që duhet të kenë pozita dhe opozita në një demokraci parlamentare. Në punën e këtyre forumeve, të organizuara në Prishtinë, morrën pjesë shumë ekspertë dhe parlamentarë me ç'rast shkëmbyen përvojat e tyre. Njëherit, gjatë kohës së qëndrimit të tyre në vendin tonë, parlamentarët shfrytëzuan rastin për të diskutuar edhe për intensifikimin e bashkëpunimit gjatë fazave të mëvonshme, duke mbajtur parasysh se ky procesi nuk përfundon me kaq. Pos kësaj, është e udhës të përmendet se si udhëheqja e Kuvendit të Kosovës, ashtu edhe deputetët të Kuvendit, kanë pasuar kënaqësinë që t'i vizitojnë këto parlamente me ç'rast janë pritur nga zyrtarët më të lartë të këtyre parlamenteve me të cilët kanë biseduar rreth çështjeve me interes reciprok.

Të vetëdijshëm se projekti ka shërbyer si një përvojë e dobishme për komunikim dhe ngritje të kapaciteteve të Kuvendit të Kosovës, shpresohet se ky projekt do të vazhdojë edhe në të ardhmen dhe do të arrijë objektiva akoma më të larta. Së këtejmi, duke mbajtur parasysh gatishmërinë e këtyre tri parlamenteve për të vazhduar mbështetjen e Kuvendit të Kosovës, në këtë fazë të zhvillimit, mbetemi me shpresë se kërkesa do të miratohet.

Intervistë me z. Faruk Spahinë, kryetar i komunës së Mitrovicës

Mitrovica shpreson për më tepër mbështetje nga institucionet qendrore

Intervistën e zhvilloi Silvan Surugiu, Zyrtar i demokratizimit për çështje të mediave në Zyrën e Misionit të OSBE-së në Mitrovicë

Çfarë bashkëpunimi ka komuna e Mitrovicës me institucionet qendrore?

Komuna e Mitrovicës ka një bashkëpunim relativisht të mirë me institucionet qendrore të Kosovës. Megjithatë, duke mbajtur parasysh situatën specifike dhe mjaft të ndryshme në komunën e Mitrovicës, kujtoj që duhet kërkuar mënyra dhe mundësi të reja, të cilat do të bëjnë të mundur jetësimin më efikas të projekteve, me qëllim të relaksimit të gjendjes, afrimit të komuniteteve dhe krijimit të parakushteve për integrimin e qytetit.

Çfarë përkrahje të drejtpërdrejtë keni nga Kuvendi i Kosovës?

Kuvendi i Komunës së Mitrovicës ka shpresuar në një mbështetje më të madhe konkrete jo vetëm për realizimin e çështjeve që u përmendën më lartë, por edhe të çështjeve të tjera, të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes së rëndë në komunë. Mirëpo, bashkëpunimi me nivelin qendror ka mbetur më tepër në suaza të deklaratave të udhëheqësve të këtij niveli për një gatishmëri për të ndihmuar në këtë drejtim, por që megjithatë nuk janë identifikuar masat konkrete për zgjidhjen e problemeve të shumta.

Cilat janë fushat në të cilat bashkëpunimi më së shumti me Kuvendin e Kosovës?

Kuvendi i Komunës së Mitrovicës ka pasur një bashkëpunim më të thekuar me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, me të cilin janë trajtuar çështje nga fusha të ndryshme me rëndësi

për Mitrovicën. Po kështu, ka pasur një bashkëpunim të Kuvendit të Komunës me komisionet e ndryshme të Kuvendit të Kosovës, ku janë diskutuar dhe trajtuar çështje me interes për qytetarët e Mitrovicës, në përgjithësi dhe për procesin e demokratizimit në Mitrovicë dhe integrimin e qytetit, në veçanti. Anëtarët e komisioneve të Kuvendit të Kosovës janë zotuar se për çështjet, që janë diskutuar në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës do të raportojnë edhe në Kuvendin e Kosovës për të ndihmuar në gjetjen e zgjidhjeve të këtyre problemeve.

A ka reagime, sugjerime apo rekomandime nga deputetët e Kuvendit të Kosovës për punën tuaj?

Udhëheqja e Kuvendit të Komunës konsideron se ka ofruar një hapësirë të mjaftueshme për informim të ndërsjellë me deputetët e Kuvendit të Kosovës. Ndaj ne e kemi shfrytëzuar dhe e shfrytëzojmë shpesh këtë vullnet, me qëllim të trajtimit të çështjeve me interes për komunën në formën më të përshtatshme dhe në momentin me të volitshëm.

A do të thotë kjo se ka edhe kritika nga ana e Kuvendit të Kosovës për punën që ju bëni në komunën tuaj?

S'do mend se ka pasur edhe raste kur janë bërë kritika për punën e Kuvendit të Komunës. Kjo sidomos është bërë për mënyrën dhe kohën e realizimit të standardeve për Kosovën, me ç'rast është kërkuar një punë dhe efikasitet më i madh në përmbushjen e tyre.



Cilat janë detyrat dhe objektivat kryesore të Kuvendit Komunal për vitin 2005?

Sipas planit të punës për këtë vit, të miratuar nga Kuvendi i Komunës, prioritetet kryesore janë: implementimi i një vargu projektesh të infrastrukturës, të cilat do t'ua lehtësonin jetën qytetarëve, dhe realizimi i procesit të kthimit të të zhvendosurve nga komuna, në pronat e tyre, pa marrë parasysh përkatësinë etnike. Ndërsa realizimi i projekteve të ndryshme të infrastrukturës ka hasur në probleme financiare për shkak të zvogëlimit të buxhetit të komunës nga Ministria për Ekonomi dhe Financa, realizimi i procesit të kthimit në komunë është në rrugë të drejtë. Kanë përfunduar së ndërtuari të gjitha shtëpitë e serbëve në Frashër dhe tani pritet kthimi i familjeve serbe në to. Aktualisht në Frashër janë duke jetuar tri familje serbe, ndërsa dy familje të tjera qëndrojnë aty

kohë pas kohe. Së këtejmi, Kuvendi i Komunës u ka bërë thirrje familjeve serbe që të kthehen, ngase tanimë janë krijuar kushtet e përshtatshme dhe parashikohet ato të sigurisë. Pos kësaj, Kuvendi i Komunës ka nënshkruar edhe një marrveshje me UNMIK-un për kthimin e romëve dhe ashkalinjëve në lagjen e tyre në pjesën jugore. Ndaj, pritet që brenda vitit aty të kthehen afro 100 familje, që gjerë më tani kanë jetuar në kushte të shumë të rënda nëpër kampe në pjesën veriore të qytetit. Së fundi, është e udhës të vihet në dukje se Kuvendi i Komunës dhe UNMIK-u kanë kërkuar nga KFOR-i që të bëjë vlerësimin e gjendjes së sigurisë në pjesën veriore, të qytetit në mënyrë që të fillojë kthimi i shqiptarëve të zhvendosur në pronat e tyre. Ndaj, shpresohet se që procesi i kthimit të shqiptarëve të fillojë aty diku nga vjeshta, i cili do të fillojë me kthimin e afro 17 familjeve në lagjen "Kroi i Vitakut".

Mbështetja Kuvendit të Kosovës



Fjalor i shprehjeve parlamentare dhe ligjore

Misioni i OSBE-së në Kosovë në bashkëpunim me Sekretariatit e Kuvendit të Kosovës, Zyrën e kryeministrit, Zyrën në Shkup të Institutit Nacional Demokratik (IND), dhe Universitetin e Prishtinës kanë përfunduar projektin për përpilimin e "Fjalorit të shprehjeve parlamentare dhe ligjore" në tri gjuhë, anglisht, shqip, sërbsisht. Projekti kishte për qëllim që të mbështesë institucionet e Kosovës gjatë hartimit të legjislacionit dhe të bëjë të mundur funksionimin e tyre në shumë gjuhë. Fjalori është një përmbledhje e termave problematike parlamentare dhe ligjore me të cilat ndeshen si stafi profesional ashtu edhe përkthyesit gjatë punës së tyre të përditshme. Ky fjalor ka 880 faqe me 1600 terme në të tri gjuhët, dhe është në dispozicion edhe në versionin elektronik. Fjalor është shpërndarë nëpër të gjitha zyrat ligjore dhe shërbimet e përkthimit të IPVQ-ve.

Rritja e kualitetit dhe e konsistencës shumëgjuhësore të projekt legjislacionit

Në mesin e muajit prill ka filluar projekti gjithpërfshirës për themelimin e Njesisë për Standardizimin/Rishikimin e Legjislacionit. Kjo njësi është përgjegjëse për mbështetjen e procesit të hartimit të legjislacionit në Kuvend, shqyrtimin dhe verifikimin e përputhshmërisë së legjislacionit të Kosovës me standardet evropiane, ngritjen e kapaciteteve të Departamentit Ligjor për të hartuar dhe shqyrtuar legjislacionin, si dhe sigurimin e pajtueshmërisë shumëgjuhësore të projekt legjislacionit në të tri gjuhët. Pos kësaj, në këtë projekt do të shqyrtohet edhe mundësinë për themelimin e një nën-komisioni për të drejta të njeriut, ashtu si është sugjeruar nga Ombudspersoni i Kosovës. Projekti "Rritja e kualitetit dhe konsistencës shumëgjuhësore të projekt legjislacionit" ka për qëllim që t'a plotësojë zbrastësinë jo vetëm ndërmjet dy projekteve të financuara nga AER-i por edhe si pjesë e bashkëpunimit të donatorëve të ASI-it. Projekti është duke u financuar nga OSBE-ja, ndërsa është duke u implementuar nga Institut International de Paris La Defense.

IND-ja (NDI-ja) ofron këshilla për seanca të mbikëqyrjes

Në mesin e muajit prill Instituti Nacional Demokratik (IND-ja) mbajti disa seminare njëditor me kryetarët e komisioneve të Kuvendit

dit me ç'rast përfaqësuesit e këtij Instituti i dhanë këshilla pjesëmarrësve rreth kontrollit parlamantar të qeverisë. Çështja kryesore për të cilin u diskutua ishte seancat e mbikëqyrjes, të cilat ua bëjnë të mundur komisioneve që t'i vlerësojnë politikën e qeverisë në fusha të caktuara si dhe shkallën e implementimit të legjislacionit. Vlen të vihet në dukje se me këtë rast shumica e kryetarëve dhe zëvendëskryetarëve morrën pjesë në diskutim.

Vizita Parlamentit të Greqisë në Athinë

Programi i Parktikës Parlamentare Lindje- Perëndim (EWPPP), si një organizatë e programit të ASI-it, e financuar nga Ministria për Punë të Jashtme e Holandës, ka ndihmuar në realizimin e vizitës së një delegacioni të Kuvendit në Parlamentin e Greqisë në Athinë. Qëllimi i vizitës ishte që të diskutohej për praktikën parlamentare, bashkëpunimin rajonal dhe marrëdhëniet bilaterale. Delegacioni përbëhej nga kryetari i Kuvendit z. Daci, shefat e grupeve parlamentare dhe përfaqësuesit e LSKM-së. Kjo ishte vizita e parë e përbashkët e z. Daci me përfaqësuesit e LSKM që nga marsi i vitit 2004. Gjatë vizitës së tyre nga 30 marsi deri me 1 prill 2005, delegacioni pati kënaqësinë që të takojë me Zëvendëskryetarin e Parlamentit të Greqisë, me kryesuesin e delegacionit të Greqisë në Këshillin e Ansamblesë Parlamentare të Evropës si dhe me ish ministrat e punëve të jashtme të Greqisë dhe me anëtarë të komisioneve parlamentare. Bisedat u përqëndruan në praktikën e komisioneve hetimore, marrëdhëniet ndërmjet qeverisë dhe partive opozitare, pjesëmarrjen në sesionet e Këshillit të Evropës, bashkëpunimin bilateral dhe rajonal dhe integrimin evropian.

Përkrahje për Komisionin e Kuvendit për Arsim

Gjatë diskutimeve gjithpërfshirëse midis kryetarit të Komisionit të Kuvendit për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, projektit të AER-it për arsim profesional dhe asistencë në trajnim dhe OSBE-së, pjesëmarrësit identifikuan disa mangësi në legjislacionin për arsim. Ndaj, komisioni ka kërkuar nga ekspertët këshilla për mënyrën e përgatitjes së dëgjimeve publike mbi legjislacionin e ri apo për implementimin e ligjeve. Pas këtyre diskutimeve, Misioni i OSBE-së në Kosovë ka vendosur që ta delegojë një ekspert ndërkombëtar për arsim në këtë Komision për një periudhë katër mujore, me qëllim që t'i ndihmojë komisionit lidhur me këto çështje. Me 11 maj komisioni ka mbajtur një dëgjim publik të ekspertëve për projektligjin mbi arsimin e të rriturve.

Kodi i mirësjelljes dhe përkrahja e punës për këshillëtarët politik

Në fund të prillit Qeveria e Kosovës i ka shpallur kriteret, kodin e mirësjelljes dhe përkrahjen e punës për këshillëtarët politik. Këto dokumente do t'u ndihmojnë këshillëtarëve politik për t'i përbushur më mirë detyrat e tyre në ministritë përkatëse të IPVQ-ve dhe për ta kryer funksionin ndërlidhës me Kuvendin e Kosovës. Gjatë tri viteve të fundit, roli i këshillëtarëve politik jo vetëm që nuk ishte definuar qartë në legjislacion, por madje ky rol as që ishte standardizuar nëpër ministri. Hartimi i dokumenteve të reja erdhi si rezultat i një procesi bashkëveprues dhe konsultues ku ishin të përfshirë edhe vetë këshillëtarët politik, Zyra e kryeministrit, OSBE-ja dhe DFID-i.



Delegacioni i Kosovës në Selanik, nga e majta në të djathtë:

Frenklin de Vrieze (OSBE), Lulzim Peci (KIPRED), Jakup Krasniqi (PDK), Gjylnaze Syla (AAK), Sabri Hamiti (LDK), Xhezair Murati (Vakat, 6+), Hydajet Hyseni (PDK), Oliver Ivanoviç (LSKM), Fatmir Sjediu (LDK).

Rreshiti i dytë: Kolë Berisha (LDK) dhe Nazmi Jashari (ORA).

Konferenca rajonale parlamentare me shoqërinë civile

Prej datës 14 deri më 17 prill me përkrahjen e OSBE-së, një delegacion i Kuvendit të Kosovës ka marrë pjesë në konferencën rajonale parlamentare në Selanik me temë “Legjislaturat dhe qytetarët: Promovimi i standardeve të UE-së për qeverisje të mirë dhe sundim të ligjit në nivel vendor dhe rajonal”. Konferenca u organizua nga Projekti i Praktikës Parlamentare Lindje-Perëndim (EWPPP). Në këtë konferencë morrën pjesë përfaqësuesit e parlamenteve dhe shoqërisë civile të Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Maqedonisë, Serbisë, Malit të Zi dhe Kosovës. Me këtë rast, delegacioni i Kuvendit të Kosovës, që përbëhej nga anëtarët e të gjashtë grupeve parlamentare, pati kënaqësinë që ta prezantojë punën e Kuvendit gjatë procesit legjislativ, përfshirjen e shoqërisë civile në dëgjimet publike, mekanizmat për rritjen e transparencës përfshirë këtu edhe Monitoruesin e Kuvendit. Pos kësaj, janë parashikuar edhe nisma të tjera, si vazhdimësi e dialogut parlamentar rajonal, nga EWPPP për vitet 2005-2006.

Studentët praktikantë punojnë me grupet parlamentare

Më 13 maj Misioni i OSBE-së në Kosovë nënshkroi një marrëveshje për “Programin e praktikantëve” me shefat e grupeve parlamentare të partive kryesore politike. Projekti, në të cilin fillimisht nga dy studentë të universitetit do të caktohen për të marrë pjesë dhe për të punuar për secilin grup parlamentar, do të zgjasë së paku një vit. “Unë besoj se praktikantët do ta kuptojnë më mirë funksionimin e Kuvendit dhe se ata do të jenë në gjendje që t’ua transmetojnë këto njohuri studentëve të tjerë në universitet”, ka thënë ambasadori Verner Vnent, Shefi i Misionit të OSBE-së, në ceremoninë e rastit që u mbajt në Kuvend. “Ky projekt mund ta përmirësojë procesin demokratik për gjenaratat e ardhshme, ngase disa nga këta studentë mund të vendosin ta vazhdojnë angazhimin e tyre politik. Njëherit, OSBE-ja beson se kjo përkrahje do ta ndihmojë edhe punën e grupeve parlamentare”. Detyrat e praktikantëve do të jenë mbajtja e procesverbalit për takimet e grupeve parlamentare dhe të komisioneve, përgatitja e rendeve të ditës dhe ftesave, përkrahja administrative dhe teknike, hulumtimi i çështjeve të caktuara politike dhe ligjore, si dhe përgatitja e pikave për diskutim për shefat e grupeve përkatëse parlamentare.



Kuvendi shqyrtoi Rregulloren e Punës

Gjatë muajve të fundit Kuvendi i Kosovës ka shqyrtuar Rregulloren e Punës. Virtyt Ibrahimaga, i cili ka punuar me Kuvendin për ta siguruar cilësinë dhe qartësinë e tekstit si edhe koncenzusin e anëtarëve, reflekton mbi funksionimin e njerës nga shtyllat e demokracisë parlamentare.

Virtyt Ibrahimaga, Këshillëtar i lartë ligjor në Kuvendin e Kosovës.

Rëndësia e rregullave parlamentare

Ligji i procedurës parlamentare është një nga instrumentet kryesore të demokracisë. Ai është zhvilluar gjatë praktikës më se pesëqind vjeçare në institucionet demokratike.

Shumë njerëz janë të njoftuar me njerën apo traditën tjetër procedurale, siç është procesi i koncenzusit që shfrytëzohet nga shumë aktivistë, parti politike, grupe religjioze dhe grupe të tjera të shoqërisë civile. Këto tradita janë të pranuar mirë për qëllimet e këtyre grupeve, ku ka një lidhje të përbashkët të fortë, dhe është me rëndësi që çdo individ ta shpreh mendimin e vet ose të saj, ose qëllimi kryesor të jetë zgjerimi i mirëqenies të të gjithë anëtarëve.

Mbledhjet parlamentare kanë qëllim tjetër: që puna të kryhet në mënyrë më efektive, duke i lejuar anëtarëve që ta kryejnë punën e tyre të vërtetë, duke u siguruar se vendimet merren në mënyrë të drejtë dhe me respektimin e të drejtave të atyre që nuk e përbëjnë shumicën. Parimisht, qëllimi i procedurës parlamentare është që t'u lehtësohet njerëzve puna efektive e përbashkët dhe që t'u ndihmohet grupeve në përbashkëtimin e qëllimeve të tyre.

Procedura parlamentare nuk është ligj i përgjithshëm. Ajo përmban rregullat që janë të aplikueshme vetëm për një grup njerëzish. Një parim fundamental i ligjit parlamentar është se kuvendi deliberativ është një trup autonom që gëzon lirinë për ta udhëhequr punën e vet në pajtim me dispozitat e veta për të drejtat e anëtarëve të vet

dhe vetes si kuvend. Është i lirë që t'i miratojë rregullat e veta, të zgjedhë udhëheqësin e vet, dhe që ta ruajë kontrollin që e dëshiron mbi punët e veta.

Parimet themelore të procedurës parlamentare janë: vendimet me shumicë votash, të drejtat dhe privilegjet e barabarta, obligimet e barabarta, mbrojtjen e të drejtave të minoritetëve, dhe diskutimin e plotë dhe të lirë. Procedura parlamentare është një grup rregullash për udhëheqjen e mbledhjeve parlamentare përderisa i lejohet secilit që të dëgjohet dhe që t'i marrë vendimet me qartësi.

Një nga përgjegjësitë kryesore të kryesuesve është që ta shfrytëzojnë autoritetin e tyre për t'u siguruar se të gjithë personat që marrin pjesë në mbledhje trajtohen njëjtë--për shembull, të mos u lejohet atyre më të zëshmeve të dominojnë me debatet. Parimi i demokracisë është thelbësor për vendimmarrje. Vota e shumicës vendos për një çështje. Në çfarëdo grupi, çdo anëtar pajtohet që të udhëhiqet nga vota e shumicës. E drejta për të votuar është e kufizuar për anëtarët që janë të pranishëm në mbledhje kur në të vërtetë bëhet votimi. Rregullat parlamentare mundësojnë që mbledhja ta përcaktojë vullnetin e shumicës së atyre që marrin pjesë në mbledhje, pas prezentimit të mjaftueshëm të argumenteve nga të gjitha palët. Çdo çështje e prezentuar për diskutim duhet të diskutohet plotësisht. E drejta e secilit anëtar për folur për cilëndo çështje është poaq e rëndësishme sa edhe e drejta e secilit anëtar për të votuar. Megjithatë, duhet të shmangët përsëritja e argumenteve dhe debatet pa

fund me qëllim që të mundësohet procesi i vendimmarrjes.

Ç'ka të re në Rregulloren e Punës?

Projekti i financuar nga AERI "Përkrahja për Kuvendin e Kosovës" kishte për qëllim të ndihmonte përgatitjen e draftit të ri të Rregullores së Punës të Kuvendit të Kosovës. drafti iu prezentua Kryesisë dhe ad hoc Komisionit për Rregulloren e Punës. Takimi i parë lidhur me draftin u mbajt më 27-28 dhjetor 2004 në Ohër, me përkrahje të NDI-së dhe Misionit të OSBE-së në Kosovë. Drafti, ashtu si u prezentua, u pranua në parim nga Kryesia dhe nga Komisioni për Rregulloren e Punës. Atëherë është arritur pajtimi që Komisioni për Rregulloren e Punës duhet ta marrë draftin e projektit si tekst bazik. Drafti është diskutuar përbrenda komisionit në dy seanca të njëpasnjëshme, kur edhe janë përgatitur disa amandamente. Puna e komisionit ishte shumë e suksesshme dhe vendimarrja ishte e bazuar në koncenzus.

Ky angazhim përfshinte në vete këshillat e ekspertëve ligjorë nga tri parlamentet evropiane; Bundestagut gjerman, Asamblesë Nationale të Republikës së Francës dhe Dhomës së Përfaqësuesve të Belgjikës. Kujdes i posaçëm i është dhënë çështjeve të ndërlydhura me mekanizmat për kontrollin e qeverisë dhe implementimin e ligjeve, transparencën dhe efikasitetin e punës së Kuvendit, çështjeve të brendshme midis organeve kryesore të Kuvendit, qartësisë së rregullave dhe mbrojtjes të të drejtave të komuniteteve dhe

pakicave politike. Në të njëjtën kohë, kujdes i është kushtuar edhe pajtueshmërisë së rregullave me procedurat standarde parlamentare dhe me praktikën e parlamenteve evropiane si dhe përfshirjes së dispozitave për implementimin e standardeve të adresuara Kuvendit të Kosovës.

Projekti kishte për qëllim përkufizimin e qartë në rregullat e reja të rolit dhe përgjegjësisë të organeve kryesore të Kuvendit siç janë Kryesia, grupet parlamentare dhe komisionet. Një nga organet më të rëndësishme kryesore të parlamentit për seancën janë grupet parlamentare pasi që ato japin iniciativat e mundshme për agjendën e Kuvendit. Me qëllim që të rritet roli i tyre, projekti ka propozuar rregulla të reja në lidhje me grupet parlamentare të cilat do t'u japin të drejtë atyre që të punësojnë personel që pastaj të jenë në gjendje t'i kryejnë detyrat e tyre politike përbrenda Kuvendit.

Gjithashtu janë të përfshira edhe dispozitat e reja për punën e komisioneve. Nga këndvështrimi i projektit, ishte shumë e rëndësishme që komisionet të merren vetëm me çështjet e kufizuara që hyjnë në kuadër të kompetencave të tyre. Gjithashtu, për hir të efikasitetit të punës së komisioneve ishte e rëndësishme që çdo anëtar i Kuvendit të marrë pjesë në punën e vetëm një komisioni. Me qëllim të përmirësimit të procedurës për leximin e dytë, janë të përfshira dispozitat për raportuesin e komisionit. Për çdo raportim të komisionit do të emërohet një raportues, i cili do t'i paraqesë amandamentet, rezolutat, propozimet

ose raportet e komisionit në seancën plenare. Krijimi i komisionit udhëheqës (komisioni i mëparshëm funksional) ishte gjithashtu me rëndësi të madhe, dhe do ta ketë rolin kryesor në një çështje të caktuar. Ai do të raportojë në seancën plenare për projektligjet dhe amandamentet e dorëzuara nga organet parlamentare dhe do t'i rekomandojë seancës që t'i miratojë amandamentet të cilat janë të dobishme për t'i bërë projektligjet më të mira.

Rregulat e reja lidhur me Kryesinë e theksojnë rolin e saj në përgatitjen e seancës plenare, menaxhimin me Kuvendin, dhe ndërveprimin me grupet parlamentare. Mekanizmat për mbajtjen e rendit në seancën plenare janë qartë të përkufizuar.

Me Rregulloren e re të Punës, është përfurcuar pozicioni i qeverisë. Rregullat e reja gjithashtu e përfshijnë edhe votimin e "besimit" dhe të "mosbesimit" për Kryeministrin. Për t'iu shmangur mocioneve destruktive të besimit të cilat mund të shpien deri te krizat politike, është propozuar që të përfshihen mocionet konstruktive të besimit dhe vota e besimit për kryeministrin. Dispozitat e reja kanë të bëjnë me kontrollin parlamentar të punës së qeverisë. Për më tepër, në çdo seancë të Kuvendit së paku dy orë do të jenë të rezervuara për pyetjet dhe përgjigjet me Qeverinë. Megjithatë, pyetjet duhet të dorëzohen më së voni 5 javë pune para seancës. Gjithashtu janë të përfshira edhe instrumentet e ndërveprimit me shoqërinë civile dhe dispozitat për mbajtjen e dëgjimeve publike.

Në fund, kisha dashur të theksoj se Rregullorja e re e punës është në pajtueshmëri të plotë me parimet e demokracisë parlamentare dhe me kërkesat e Planit për implementimin e standardeve për IPVQ-të.



vijon nga faqja 7

e theksuar gjysmën e zbrazët të gotës. Anëtari serb i Kuvendit të Kosovës vërejt se vetëm pas gjashtë vitesh në Kosovë, bashkësia ndërkombëtare vërtetë e ka ndryshuar qëndrimin e vet dhe ka kuptuar se serbët e mbetur të Kosovës duhet të mbrohen dhe përkrahen në mënyrë efikase. Megjithatë, z. Ivanoviq e sheh si fatkeq "transferin e shpejtë të kompetencave në institucionet gjysmë të pjekura" dhe fillimin e negociatave për statusin përfundimtar para se masat kuptimplota për mbrojtjen e serbëve të Kosovës dhe inkurajimi i kthimit të tregojnë rezultat. Z. Ivanoviq vlerësoi se përfundimi i vitit shkollor aktual do të jetë thelbësor për mbijetesën e komunitetit serb në Kosovë. Duke e vërejtur se më tepër njerëz po e kuptojnë se vendimi për të bojkotuar zgjedhjet e tetorit 2004 ishte i gabueshëm, ai shprehu shpresën e tij që popullata serbe e Kosovës mund të bindet se ka gjasa të mira që IPVQ-të do të jenë në gjendje t'i shërbejnë edhe intereseve të tyre. Z. Ivanoviq e përfundoi fjalimin e tij me një ton optimist, duke folur për domosdoshmërinë e një marrëveshjeje të qëndrueshme politike, heqjen dorë nga idetë radikale ose ekstreme, dhe fillimin e negociatave për një zgjidhje afatgjate "të udhëhequr nga fryma e mirëfilltë e paqes dhe përkushtimit ynë për ta krijuar një Kosovë të re për fëmijët tanë".

ASI
NEWSLETTER

Rruga Beogradi 32, 38000 Prishtinë

Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188

kontakt: franklin.devrieze@osce.org

<http://www.osce.org/kosovo>

Pikëpamjet e shprehura nga ata që kontribuan në këtë buletin, iu përkasin vetem atyre dhe jodomosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e Kuvendit, Misionit të OSBE-së në Kosovë apo të organizatave partnere të ASI-t

Fotografitë e këtij buletini : Gazeta Express faqet 1, 10, 19 (Atdhe Mulla), 4, 5 (Astrit Ibrahim), 8 (Ermal Meta), 11 (Ferdi Limani); Kuvendi i Kosovës: faqe14, OSBE-ja faqet 2, 6, 9, 13, 15,16, 17 ; Zyra e ndërlidhjes e SHBA-ve faqe 12.

Përbërja e komisioneve të Kuvendit

1. Komisioni për Buxhet dhe Financa (12 anëtarë)

1. Naser Osmani, Kryetar- LDK
2. Snežana Milić, Zëvendëskryetare e parë- SLKM
3. Safete Hadërgjonaj, Zëvendëskryetare e dytë- PDK
4. Behxhet Brajshori, Anëtar - LDK
5. Besa Gaxheri, Anëtare - LDK
6. Lutfi Zharku, Anëtar - LDK
7. Naxhije Doçi, Anëtare - LDK
8. Gani Koci, Anëtar - PDK
9. Demir Lima, Anëtar - PDK
10. Mazllom Kumnova, Anëtar - AAK
11. Rifat Krasniç, Anëtar - KDTP, 6+
12. Nazim Jashari, Anëtar - ORA

2. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim (13 anëtarë)

1. Rande Nojkic, Kryetar- SLKM
2. Sanije Aliaj, Zëvendëskryetare e parë- LDK
3. Mahir Yağcilar, Zëvendëskryetar i dytë- KDTP, 6+
4. Nait Hasani, Anëtar- PDK
5. Slaviša Petković, Anëtar - GIS
6. Nuran Malta, Anëtare - KDTP
7. Džezair Murati, Anëtar - Koalicija Vakut, 6+
8. Numan Balić, Anëtar - SDA
9. Sabit Rrahmani, Anëtar - PDAK
10. Xhevdet Neziraj, Anëtar - IRDK
11. Bislim Hoti, Anëtar - IRDK
12. Zylfi Merxha, Anëtar - PRBK
13. Ibishi Rustem, Anëtar - GIG

3. Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese me nënkomisionet për Barazi Gjinore, Peticione dhe Ankesa Publike dhe për Persona të (12 anëtarë)

1. Hydajet Hyseni, Kryetar- PDK
2. Kolë Berisha, Zëvendëskryetar i parë - LDK
3. Shpresa Murati, Zëvendëskryetare e dytë- KDTP, 6+
4. Ymer Muhaxheri, Anëtar - LDK
5. Sadudin Berisha, Anëtar - LDK
6. Ramadan Kelmendi, Anëtar - LDK
7. Lumnije Hyseni, Anëtar - LDK
8. Nerxhivane Dauti, Anëtar - PDK
9. Hajredin Kuçi, Anëtar - PDK
10. Gjylnaze Sylja, Anëtar - AAK
11. Dragiša Krstović, Anëtar - SLKM
12. Veton Surroi, Anëtar - ORA

4. Komisioni për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim në UE (12 anëtarë)

1. Sabri Hamiti, Kryetar- LDK
2. Bajram Rexhepi, Zëvendëskryetar i parë -PDK
3. Mahir Yağcilar, Zëvendëskryetar i dytë- KDTP, 6+
4. Fatmir Sejdiu, Anëtar - LDK
5. Ilmi Ahmeti, Anëtar - LDK
6. Rudina Bukoshi, Anëtare - LDK
7. Alush Gashi, Anëtar - LDK
8. Jakup Krasniqi, Anëtar - PDK
9. Xhavit Haliti, Anëtar – PDK
10. Emrush Xhemaili, Anëtar - LPK - AAK
11. Slaviša Petković, Anëtar – GIS
12. Veton Surroi, Anëtar - ORA

5. Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sporte (12 anëtarë)

1. Enver Hoxhaj, Kryetar- PDK
2. Nimon Alimusaj, Zëvendëskryetar i parë - LDK
3. Gojko Savic, Zëvendëskryetar i dytë- SLKM
4. Remzije Nimani, Anëtar - LDK
5. Gjylshen Berisha, Anëtare - LDK
6. Ragip Zekolli, Anëtar - LDK
7. Mark Krasniqi, Anëtar – PSHDK- LDK
8. Drita Statovci, Anëtar - PDK
9. Sala Ahmetaj, Anëtare - PDK
10. Myrrete Dreshaj, Anëtare - AAK
11. Nuran Malta, Anëtare - KDTP, 6+
12. Genc Gorani, Anëtar - ORA

6. Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion (12 anëtarë)

1. Fatmir Rexhepi, Kryetar- LDK
2. Bajrush Xhemaili, Zëvendëskryetar i parë- PDK
3. Mahir Yağcilar, Zëvendëskryetar i dytë- KDTP, 6+
4. Ibush Jonuzi, Anëtar - LDK
5. Brikenda Kryeziu, Anëtare - LDK

6. Milazim Haliti, Anëtar - LDK
7. Fadil Gashi, Anëtar - LDK
8. Sala Berisha –Shala, Anëtare - PDK
9. Hatixhe Hoxha, Anëtare - PDK
10. Xhevdet Neziraj, Anëtar - IRDK- AAK
11. Sladan Ilić, Anëtar - SLKM
12. Teuta Sahatqija, Anëtare - ORA

7. Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor (12 anëtarë)

1. Rifat Krasniç, Kryetar- KDTP, 6+
2. Lulzim Zeneli, Zëvendëskryetar i parë - LDK
3. Goran Bogdanović, Zëvendëskryetar i dytë- -SLKM
4. Isuf Sutaj, Anëtar - LDK
5. Shaban Halimi, Anëtar - LDK
6. Zyhrije Maloku, Anëtare - LDK
7. Fetah Berisha, Anëtar - LDK
8. Berat Luzha, Anëtar - PDK
9. Afrim Arzuahxhiu, Anëtar - PDK
10. Xhelal Canziba, Anëtar - PDK
11. Sylejman Qerkezi, Anëtar – PD-AAK
12. Nazim Jashari, Anëtar - ORA

8. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale (12anëtarë)

1. Fatmire Mulhaxha-Kollqaku, Kryetare- ORA
2. Naim Jerliu, Zëvendëskryetar i parë - LDK
3. Shpresa Murati, Zëvendëskryetare e dytë- KDTP, 6+
4. Ilaz Pireva, Anëtar - LDK
5. Nurisha Hula, Anëtare - LDK
6. Nafije Berisha, Anëtare - LDK
7. Fehmi Vula, Anëtar - LDK
8. Flora Brovina, Anëtare - PDK
9. Teuta Hadri, Anëtare - PDK
10. Zahrije Jusufi, Anëtare - PDK
11. Zylfije Hundozi, Anëtare - AAK
12. Zlatica Kujundić, Anëtare – SLKM-GIS

9. Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media (12 anëtarë)

1. Nekibe Kelmendi, Kryetare - LDK
2. Fehmi Mujota, Zëvendëskryetar i parë- PDK
3. Oliver Ivanović, Zëvendëskryetar i dytë- SLKM
4. Ramadan Musliu, Anëtar - LDK
5. Nexhat Rexha, Anëtar - LDK
6. Kamber Kamberi, Anëtar - LDK
7. Jonuz Kastrati, Anëtar - LDK
8. Hajredin Hyseni, Anëtar - PDK
9. Selville Halimi, Anëtare - PDK
10. Ymer Halimi, Anëtar - AAK
11. Shpresa Murati, Anëtare - KDTP 6+
12. Ylber Hysa, Anëtar - ORA

10. Komisioni për Gatishmëri dhe Emergjencë (12 anëtarë)

1. Naim Maloku, Kryetar- AAK
2. Ylber Hysa, Zëvendëskryetar i parë- ORA
3. Xhezair Murati, Zëvendëskryetar i dytë- Koalicija Vakut, 6+
4. Agim Krasniqi, Anëtar - LDK
5. Fadil Geci, Anëtar - LDK
6. Samije Zeqiraj, Anëtare - LDK
7. Fadil Kryeziu, Anëtar - LDK
8. Qibrrije Hoxha, Anëtare - LDK
9. Sokol Bashota, Anëtar - PDK
10. Emin Krasniqi, Anëtar - PDK
11. Arsim Bajrami, Anëtar - PDK
12. Vesna Jovanović, Anëtare - SLKM

11. Komisioni për Rregulloren e Punës së Kuvendit (12 anëtarë)

1. Hajredin Kuçi, Kryetar -PDK
2. Bislim Hoti, Zëvendëskryetar i parë - IRDK- AAK
3. _____ Zëvendëskryetar i dytë- SLKM
4. Kolë Berisha, Anëtar - LDK
5. Nekibe Kelmendi, Anëtare - LDK
6. Fatmir Sejdiu, Anëtar - LDK
7. Ramadan Kelmendi, Anëtar - LDK
8. Naim Jerliu, Anëtar - LDK
9. Gani Koci, Anëtar - PDK
10. Hydajet Hyseni, Anëtar - PDK
11. Mahir Yağcilar, Anëtar - KDTP, 6+
12. Nazim Jashari, Anëtar - ORA